

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XIX i botimit, nr. 227, Gusht 2022
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro


I dhurohet qytetit të Shkodrës, përmendorja e princit Lekë Dukagjini

Prezantohet një tjetër projekt për zonën e Alpeve Shqiptare

Me datë 23 Shtator 2022 në orën 10.30 në ambientet e qendrës Rinore "Arka" u prezantua një tjetër projekt për zonën e Alpeve Shqiptare CNVP – Fondacioni Bashkëpunim Vlerat Natyrore me Njerëzit, përmes degëve të saj në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut, tani do të zbatohet një projekt të ri tre-vjeçar me titull "Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore për zhvillimin ndërkufitar socio-ekonomik të zonave të mbrojtura ..."

Përrurimin e Kishës së re në Curraj të Epërm

Të nderuar vëllezër e motra! Të dashur pjesëmarrës! E nderuara Ministre e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë të Republikës së Kosovës, znj. Rozeta HAJDARI! I nderuari deputet në Kuvendin e Shqipërisë, z. Lavdrim KRASHI, që e latë Londrën për të shërbyer e kontribuar për Dibrën e Shqipërinë! I nderuari Kryetar i Këshillit të Qarkut të Kukësit, z. Abdulla DOMI! I nderuari Kryetar i Bashkisë Tropojë, z. Rexhë BYBERI! I nderuari Kryetar i Bashkisë Pukë, z. Gjon GJONAJ! Të nderuar ambasador Flamur GASHI dhe gjeneral PRENGA! I nderuari Kryetar i Njësisë Shqipërisë! ...



Kryqi që shikon Dukagjinin, Shala mrekullia e Alpeve Shqiptare!

Disa ditë më parë më kishte njoftuar profesori Luigj Shyti se në Alpet tona nga vëllezërit Nika do të vendoset një KRYQ madhështor me shikim nga lugina e Shalës e më përtej, sinqerisht e mirëprita këtë shkëlqim hyjnor në Dukagjinin tonë të dashur. Dukagjini i shtrirë në gjirin e alpeve, i cili ngjitet në majën e tyre, në fillimin e bjeshkëve të Namuna (emërtes e gojëkeqit), aty ku zanat fluturojnë lirisht përmbi luginën e Shalës drejt ...

Një vit pa ty, por ti gjithmonë midis nesh

E shtuna e 10 Shtatorit të këtij viti, për Shkodrën, Dukagjinin dhe gjithë njerëzinë, ishte si gjithmonë thjeshtë një ditë vjeshte. Por për familjen, të afërmit, miqtë, shokët dhe bashkëpunëtorët e "MJESHTRIT TË MADH" Mëhill Çun Gjonaj, ishte një ditë malli, kujtese e reflektimi në kujtim të emrit dhe veprës së tij, pasi pikërisht në këtë ditë të paharruar, u mbush plot një vit që artisti dhe "Mjeshtri i Madh" u nda nga jeta, duke lënë pas prapësi të mëdha, të ndërtuar e skalitur me mjeshtri të rrallë...

PAS ÇDO ARRITJEJE VJEN NISJA, PAS ÇDO REZULTATI NJË SFIDË E RE!

Me këtë përcaktim e fillova të shkruaj disa mendime për librin, me titull "Tranzicion në udhëkryq", të autorit N/kolonel Mhill Pali.

Kush është Mhill Dede Pali? Mhill Pali, u lind në fshatin Gjuraj, të krahinës së Pultit, me 16 janar 1944. Shkollohet në Tiranë në nivelin e shkollës së mesme të përgjithshme. Dëshiroi të milituar në radhët ...

DERI KUR?!

Ne jemi të ndërgjegjshëm për krizat, të cilat kanë përfshirë pothuajse gjithë botën. Lufta në Ukrainë ka goditur më rëndë Evropën, brenda së cilës jemi edhe ne. Kuptohet, ne jemi një vend i vogël, por resurset i kemi të mëdha, kjo falë zemërgjerësisë të Perëndisë, që është treguar aq bujar me Shqipërinë. Ne kemi fusha, male, dete, lumenjve, burime ujore, pasuri të pafundme minerare e të tjera. E me të gjitha këto, ne jemi vendi më i varfër në Ballkan, Evropë dhe rreshtohemi me vendet e varfra në botë.

Në retorikën e përditshme trumbe tohen me të madhe arritjet jo të ekonomisë. Duke bërë krahasime...



I dhurohet qytetit të Shkodrës, përmendorja e princit Lekë Dukagjini

Kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, me mbështetjen e bashkësisë dukagjinase ka vendosur që qytetit Shkodrës ti dhurojë monumentin (bustin) e Princit Lekë Dukagjini, për ta vendosur në një nga sheshet kryesore të këtij qyteti, me këto përmasa: **“Monumenti (Bustit) i Princit Lekë Dukagjini, është në mermer, me përmasa 2 m i lartë dhe së bashku me bazamentin e vendosjes të tij, 3 m, i gjithë monumenti shkon 5 m i lartë”.**

Për këtë ju, është propozua: Miratimin e sheshit për vendosjen e monumentit (Bustit) të Princit Lekë Dukagjini: **Sheshi (lulishtja në mes godinës së bashkisë dhe bibliotekës “Marin Barleti”**, me dokument Nr. 1453 prot. datë 01 / 09 / 2022.

LEKË DUKAGJINI NJË VLERË E SHTUAR KULTURORE PËR SHKODRËN E KULTURËS

Lekë Dukagjini (1410 – 1481) ishte princi më i fuqishëm shqiptar pas Gjergj Kastriotit-Skënderbeut një figurë historike spektakolare komplekse madje e legjendarizuar si bashkëkohës i tij

Historia i njeh të dy si princër trashëgimtarë, që u lartësuan, kur morën në sundim dy principatat që mbanin mbiemrat e tyre: Leka - të Dukagjinëve, pas vdekjes së të atit, Pal Dukagjini (1446) dhe Gjergji - të Kastriotëve më 1443, tetë vjet pas vdekjes së të atit, Gjon Kastriotit.

Princi Leka Fisnik i sferave më të larta, i veshur me petkat e një kulture të nivelit bashkëkohore perëndimor, me kulturë të gjithanshme me frymë humaniste të Rilindjes Evropiane fituar në qytete të tilla si Venecia, Ragusa apo Shkodra.

Dy brirësh dragonjan me Gjergj Kastriotin-Skënderbeun, problematiku, aleati, karizmatiku dhe ushta e fundit anti osmane e qëndresës arbërore.

Leka imponuesi, ligjëbërësi dhe babai shpirtërore se drejtës tradicionale shqiptare.

Historianët e kanë përfolur Lekë Dukagjinin, sepse kërkuan te ai një personazh antagonist të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, për ta intriguar jetëshkrimin e heroit të vetëm shqiptar, që njohu Evropa në përballjen e suksesshme shqiptaro-turke, por edhe sepse nuk donin të fajësonin Evropën perëndimore, që nuk arriti të krijonte një koalicion antiosman në Ballkan. Ata nuk guxuan të gjykonin, veçanërisht, Republikën e Venedikut, që jo vetëm nuk u qëndroi aleate shqiptarëve, kur mbanin mbi supet e tyre një perandori të tërë të egërsuar kundër Evropës, por e shfrytëzoi rezistencën e tyre për interesat e veta komercialiste, duke i përçarë princërit shqiptarë me intriga, duke i kundërvënë ata njëri me tjetrin edhe me armë dhe, kur nuk ia arrinte kësaj, duke i shpallur armiq të Republikës dhe të Krishterimit (Tonin Çobani: Princi

i përfolur Lekë Dukagjini)

Shumë më të ekuilibruar janë treguar legjendarizuesit anonim, të cilët i kanë identifikuar Gjergj Kastriotin-Skënderbeun si princin dragua që guxon, matet e fiton në çdo rast me këlshehdren dhe Lekë princin engjëllor, që u shfaq me guxim dhe urtësi për të ruajtur në vijimësi shqiptarizimën.

Dukagjinët, në vitin 1389 marrin pjesë në koalicionin ballkanas, në Fushë të Kosovës.

Dukagjinët, në vitin 1393 ua dorëzojnë qytetin e Lezhës venedikasve, që të mos binte nën sundimin e osmanëve, duke ruajtur të drejtën e një të tretës së të ardhurave.

Në vitin 1406, Princi Pal Dukagjini (1384-1446), i përmendur për urtësi, vihet në krye të Principatës së Dukagjinëve me kryeqendër Ulpianën (qytet i themeluar prej tij), ku mbretëron së bashku me të vëllanë Nikollë Dukagjinin, i shquar për trimëri.

Në vitin 1410 lind, në Ulpiana, pranë Lipjanit, Princi trashëgimtar i Pal Dukagjinit, Lekë Dukagjini, Leka ka pasur edhe një vëlla, Palin, me zgjuarsin të jashtëzakonshme, por të verbër; një motër, Roza, me bukuri të rrallë e shumë krenare dhe, ndoshta, një tjetër me emrin Maria, që do të bëhet gruaja e Gjon Muzakës së Beratit.

Në vitin 1432, Pal Dukagjini me të vëllanë, Nikollën, mbështesin së bashku me Topiajt Aranit Komnenin, vjehrrin e ardhshëm të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, në kryengritjen e tij të suksesshme kundër forcave osmane.

Motra e Aranit Komnenit ka qenë gruaja e Pal Dukagjinit, e nëna e Lekës.

Në vitin 2 mars 1444 Pal dhe Nikollë Dukagjini janë pjesëmarrës të Besëlidhjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut në Lezhë. Ata mbështesin Lidhjen me 5 000 ushtarë nga 15 000 që kishte gjithsej Gjergj Kastrioti-Skënderbeu. Pali shoqëron Gjergj Kastriotin-Skënderbeun në Krujë.

Në vitin 1444, Beteja e Torvjollit, në të cilin marrin pjesë edhe trupat e Principatës së Dukagjinëve nën komandën e Tanush Topisë. Pali, së bashku me princërit të tjerë, do të presë në Krujë Gjergj Kastriotin-Skënderbeun, për ta përshëndetur për fitoren.

Në vitin 1445, në dasmën e Mamicës, së motrës së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut në Muzakinë, shfaqet për herë të parë princi Lekë Dukagjini. Dueli i tij me Lekë Zakarinë për dorën e princeshës së bukur Jerina Dushmani.


Në vitin 1446 vdes Pal Dukagjini. Vendin e tij, në krye të Principatës së Dukagjinëve e zë i biri, Lekë Dukagjini.

Në vitin 1447-1448, Gjergj Kastrioti-

Skënderbeu rrethon Dejen, Shkodrën dhe Durrësin, qytete në zotërim të venedikasve. Përkrah Skënderbeut është Nikollë Dukagjini.

Në vitin 1448, Paqja e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut me Venedikasit, Lekë Dukagjini nuk merre pjesë.

Në fund të viteve '50 të shekullit XV Principata e Dukagjinëve nuk ka më asnjë nga qendrat e veta të zhvilluara: Lezha u është dorëzuar venedikasve (1393), Ulpiana, kryeqyteti i principatës, është shkatërruar me themele nga



turqit më parë se të binte në dorën e tyre Prizreni (1458), një qendër tjetër e zhvilluar e Principatës së Dukagjinëve. Në këto kushte, Lekë Dukagjini ka pushtuar kështjellën e Shatit në Zadrimë, për ta pasur si rezidencë princërore, por u sulmua nga Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, i cili ua ktheu menjëherë venedikasve. Pa një rezidencë princërore dhe, për një farë kohe, në mes të tri zjarreve (turqit, venedikasit dhe Gjergj Kastrioti-Skënderbeu), Lekë Dukagjini gjeti strehim në thellësi të maleve të principatës së tij, ku ndërtoi saraje e kështjella së bashku me banorët e lirë, që i shkonin pas, i rrethuan me mikpritje e respekt. Me malësorët e Principatës së Dukagjinëve, të njohur për trimëritë e tyre (M. Barleti:98), Leka, jo vetëm ringriti qytezë-kështjellat e veta, por siguroi në mënyrë të pandërprerë një ushtri të mjaftueshme që luajti rol të rëndësishëm në kuadrin e trupave të Lidhjes së Lezhës nën komandën e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut dhe më pas. Në këmbim të kësaj gatishmërie, Lekë Dukagjini u siguroi malësorëve të principatës së tij dhe të gjithë atyre që u bashkuan me të për të gjetur mbrojtje, veçanërisht, pas vdekjes së Skënderbeut, lirinë brenda organizimit të tyre fisnor, të cilën në kushtet e krijuara e institucionalizoi me riorganizimin e pleqësive mbi bazë fshati e krahine.

Në vitin 1461, përflitet Lekë Dukagjini se, u është drejtuar turqve për aleancë.

Papa Piu II e kërcënon me ç'kishërimin.

Në vitin 1463, Papa Piu II ndërhyr për pajtimin e Lekë Dukagjinit me Gjergj Kastriotin-Skënderbeun. Në këtë vit, viti 1463, Pajtimi i dytë me Gjergj Kastriotin-Skënderbeun, Leka bashkohet me Lidhjen e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, Venedikun dhe Ivan Cernoviçin e Malit të Zi.

Në vitin 1465, në betejën e Sfetigradit, Lekë Dukagjini shpëton prej vdekjes Gjergj Kastriotin-Skënderbeun.

Në vitin 1466, Leka dhe Nikel Moneta komandojnë 13 mijë forca shqiptare përkrah Gjergj Kastriotit-Skënderbeut kundër Ballaban Pashës.

Në vitin 1468, në Shkodër thyhen trupat osmane prej ushtrisë shqiptare pa pjesëmarrjen e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Mendohet se kjo fitore është arritur nën drejtimin e Lekë Dukagjinit.

Në vitin 1468 vdes Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, Lekë Dukagjini është ndër kryetarët shqiptarë, që iu ndodh pranë deri në çastet e fundit të jetës.

Në vitin 1477, Leka në mbrojtje të Krujës, ku duhet të ketë mbetur i plagosur, pasi u përfor se mbet i vranë.

Në vitin 1479 Venecianet nënshkruajnë pushtimin e Shqipërisë prej turqve, por

Lekë Dukagjini vazhdon rezistencën kështjellave që kishte ngritur thellësive të maleve të principatës së tij.

Në vitin 1481 Lekë Dukagjini përmendet për herë të fundit në dokumentet e kohës, duke kaluar nga Ragusa për në principatën e tij.

Në vitin 1481 mendohet vdekja e Lekë Dukagjinit, pinjollit më i fundit i Principatës së Dukagjinëve

LEKË DUKAGJINI, “BABAI” I SË DREJTËS TRADICIONALE SHQIPTARE

Kanuni, me emrin e tij është një vepër unike, me frymë humaniste e kodikut shqip, që u përgojua në mënyrë cinike e vijon të shigjetohet ende së bashku tatën Leke. Por dihet se lisat e larte janë objekt i rrufeve. Ani se vicklat inatçare i hoqën vetëm ashklat, por jo lenden e rrëshinuar të vlerësuar nga mendjet e urta, si një vepër monumentale (A. Buda), ka me tepër forcë detyruese se Bibla e Kurani (E. DURHAM) dhe kontribut në thesarin e kulturës botërore (SCHWERIN).

Thelbi i Kanunit të Lekë Dukagjinit janë fjalët e urta të dala nga goja e tij, që u ruajtën (dhe u pasuruan) brez pas brezi për gati gjashtë shekuj. Ky fenomen homerik e ka legjendarizuar emrin e Lekë Dukagjinit, duke e kthyer atë në një mit të pa shlyer.

Kanuni i Malësisë, që lidhet me emrin e Lekë Dukagjinit, por në shumë el-

Prezantohet një tjetër projekt për zonën e Alpeve Shqiptare

Me datë 23 Shtator 2022 në orën 10.30 në ambientet e qendrës Rinore "Arka" u prezantua një tjetër projekt për zonën e Alpeve Shqiptare CNVP – Fondacioni Bashkojmë Vlerat Natyrore me Njerëzit, përmes degëve të saj në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut, tani do të zbatohet një projekt të ri tre-vjeçar me titull "Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore për zhvillimin ndërkufitar socio-ekonomik të zonave të mbrojtura në Maqedoninë e Veriut dhe Shqipëri (Shqiptar Alpet, Korab-Koritnik, Shar dhe)", financuar nga Prespa Ohrit National Trust (PONT).

Në vazhdimësinë e punës së mirë që prej disa viteve fondacioni CNVP po bënë në trojet Shqiptare edhe ky projekt u prezantua me shumë profesionalizëm nga grupi i punës.

Koordinatori rajonal Mark Rupa në fillim ju uroj mirëseardhjen të pranishmeve dhe i ftoj të prezantoheshin. Pastaj ai paraqiti zonat e zbatimit dhe objektivi i projektit.

Anila Alia (këshilltare për barazinë gjinore) paraqiti rezultatet e pritshme, qëndrueshmërinë dhe menaxhimin e projektit.

Janaq Male drejtor i CNVP foli për PONT-Fondi i Mirëbesimit të Prespës dhe Ohrit, i cili është fondi i vetëm i mirëbesimit ndërkufitar që operon në Ballkan. Në vitin e parë, aktivitetet do të nisnin brenda zonave të Mbrojtura të kualifikuara PONT – parqet kombëtare të Mavrovës dhe Malit Shar, në Maqedoninë e Veriut, Parkun Natyror Korab-Koritnik dhe Parkun Kombëtar të Alpeve Shqiptare në Shqipëri. Veprimtaritë do të zgjerohen në korridoret ekologjike që i lidhin dhe me peizazhin më të gjerë, në vitin e dytë dhe të tretë.

Një program i vogël grantesh për OJQ-të lokale, shoqatat e përdorimit të burimeve, qeveritë lokale, bizneset lokale, fermerët dhe anëtarët e bashkësive do të zbatohet nga CNVP për të promovuar dhe pilotuar qasje dhe praktika të reja në turizmin e bazuar në natyrë dhe menaxhimin e prodhimeve të dyta pyjore dhe kullimore në kontekstin ndërkufitar. Kjo do të shoqërohet me veprimtari ndërgjegjësuese dhe ngritjen e kapaciteteve, duke lehtësuar pjesëmarrjen lokale në ruajtjen e natyrës, si dhe krijimin e mekanizmave efektivë të qeverisjes.

Gjatë takimit prezantues morën pjesë dhe dhanë propozimet e tyre rreth 20 aktore nga zona e Alpeve Shqiptare. Nga të pranishmë ishin dhe Pedagog të Universitetit Luigj Gurakuqi Shkodër, Projekti u vlerësua për risit dhe duke u nisur edhe nga veprimtaria e deri tanishëm i CNVP u vlerësua si mbështetje e madhe për rritjen e bashkëpunimit.

Pas paraqitjes se Florës dhe Faunës që



koha dhe faktor të ndryshëm po i rrezikojnë, ata sollën ide, të cilat gjatë zbatimit të këtij projekti mund ta ndryshojnë rrjedhën. Inxh. Agim Dardha, drejtor i Zonave të Mbrojtura falënderoj fondacioni për bashkëpunimin, i cili tashme po ecën në rrugën e duhur dhe vlerësoj shumë punën në aspektin hulumtues dhe studimor në kohë, terren dhe bashkësi.

Në zonën e Dukagjinit, përfitues do jone njësite Shalë dhe Shosh, por me shtrirje të mundshme dhe në njësite e tjera. Kjo shtrirje u kërkua nga përfaqësuesit e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" si dhe të punohet për turizmin historik.

Projekti do të fokusohet në përmirësimin e kushteve socio-ekonomike të bashkësive lokale, duke kontribuar në ruajtjen e natyrës. Ai fokusohet në përdorimin e qëndrueshëm të produkteve pyjore jo-drunore (NTFP) dhe turizmin e bazuar në natyrë dhe aplikon një qasje pjesëmarrëse, ndërkufitare dhe ndërsek-

toriale.

Takimet do vazhdojnë në të gjitha fshatrat, për të takuar të gjithë aktoret e interesuar për tu angazhuar brenda këtij projekti.

Duke marrë shkas nga ky takim falënderojmë shumë CNVP, për punën e mirë që po bënë Shalë, Shosh dhe Malësinë e Madhe, sidomos për kultivimin e bimëve Medicinale, gjë e cila e ka zbuluar dhe ka shtuar fuqinë punëtore dhe ka rritur përfitimin financiar të bashkësisë vendas.

Tashmë CNVP e ka ndezur dritën jeshile, e cila po vërtetohet se Shqipëria është e bukur, e pasur dhe po të punohet, të rinjtë Shqiptarë mund ta ndërtojnë të ardhmen në vendin tyre. Mjafton të studiojnë, të punojnë ashtu sikur Mark Rupa me shokët e tij dhe Shqipëria do jetë e bukur dhe e bekuar.

Përgatiti Roza Pjetri

ementë mund të jetë edhe më i vjetër se kjo figurë e njohur e historisë, është një univers juridik i lashtë, nënshtresa të të cilit, për nga burimi, shkojnë deri në antikitet. Formulatat e betimit nuk zënë në gojë hyjnitë me emër. Betimi "për qiell e dhe", "për kët' gur", "për kët' peshë", "për kët' bukë", shpreh një besim mitologjik. Vetëm një gjë me të vërtetë shumë e vyer mund të kapërcente shekuj të tërë për të ardhur gjer në ditët tona

Mikpritja në Kanun- Kanuni ka sanksionuar kultin e mikut dhe të mikpritjes tek shqiptarët. "Shtëpia e shqiptarit është e Zotit dhe e mikut"

Në kanun Zoti dhe miku para shtëpisë barazohen. Nuk mund të ketë hyjnizim më të madh se ky për mikun.

Nderi në Kanun - Nga kohëra shumë të hershme vjen përmes kanunit kult i nderit. Nderi tek shqiptarët ndryshon nga kodet e kalorësisë evropiane të pragut të Rilindjes. Bëhet fjalë për një nder të ashpër, por dinjitoz e madhështor në ashpërsinë e tij. Nderi në kanun nuk është një kategori morale në kuptimin e ngushtë. Për kuptimet e ngushta kanuni kishte ndalime të tjera. Një familje shqiptare, para se të vendoste pranimin e një krushqie të re, duhej të hetonte nëse largësia midis brezave të gjakut e të tamblit (në linjë mashkullore dhe femërore), ishte më shumë se shtatë breza. Kishte rajone që duhej të kalonin 12 breza. Për vendin, që i ka dhënë popullsia malësore nderit, që shkrinte dy kulte, atë të bujarisë (të mikut) dhe të urtësisë (të pleqve), mjafton t'u referohemi dy paragrafëve të njëpasnjëshëm të kodit: "Ndera e marrun ka gjakun" (nyje, 598)

Besa, ose kulti i fjalës së dhënë, lidhet në burim me mitin biblik të fjalës: "Në fillim qe fjala!". Më parë se të ishte shkrimi, kontrata, marrëveshja, noteria, gjyqi, shteti, popujt, njeriu, bota vetë, ishte fjala. Ky kult madhështor, i cili, në popujt evropërendimorë, pak nga pak Shqipëria

që e pushtuar, për pesë shekuj nga perandoria otomane, por Kanunin ajo nuk arriti ta nënshtrojë. Në mori karakterin e një idiomie fetare kishtare, tek shqiptarët ruajti gjurmën e burimit.

Ismail Kadare, në një ese të tij, figurativisht këtë e ka quajtur "jus albanicae", "e drejta e shqiptarit". Sot kanuni është një "opus finita" një herë e përgjithnjë, është "një botë e mbyllur". E. Çabej, qysh në vitin 1935, në veprën "Elemente të literaturës dhe të gjuhës shqipe", e përfshiu Kanunin në antologjinë e vlerave letrare të përzgjedhura për nevojat e shkollës.

HERO SHPIRTËROR KOMBËTARE I GDHENDUR NDOSHTA SI ASKUSH TJETËR NË AQ SHUMË TOPONIME:

Guri Lekës në Shosh, Kalaje Lekë Dukagjinit-në Va Spas, Logu i Lekës-në Krasniqe.

Fusha e Lekë Dukagjinit: (mbi Gominë) Pukë: **Shpella i Lekës:** në Mërtur të Gurit, **Qyteza e Lekë Dukagjinit,** gjendet në afër majës së Forcës, **Sofra i Lekë Dukagjinit:** në Berishë, **Shkëmbi i Lekës,** në Fan dhe Rajë; **Lisi i Lekës** në katum Pap, të Bajrakut të Çukës, **Kulla e Lekës:** në Pap të Bajrakut të Pukës; **Kroni i Lekës:** në Kurthpule, **Sarajet e Lekës** në Pjan të Krasniqes, **Pemët e Lekës:** Berishë, **Shqiponja e Lekës:** Shqiponje kokë bardhe mbi shkrepat për mbi Saraje të Lekës në Krasniqe kishin folenë shqipet kokë bardha ndryshe nga të zakonshmet

LEKË DUKAGJINI NJË VLERË E SHTUAR KULTURORE

Leka endet në memorien kolektive si kalores i legjionit të nderit, veshur me mantelin e heroit tone shpirtërore. Atë, që kemi pare pesëqind vjet me sytë e shpirtit dhe të mendjes do ta shohim së shpejti në një memorial në zemër të Shkodrës.

Mërgimtarët dukagjinës në Australi,

të iniciuar nga Kujtim DELIA i Shoqatës "Bashkësia shqiptare" (Itali), me kryetar Gjergj Temeli, grupi investitorëve "Shaljanët për vendlindjen", në SHBA, të kryesuar Gjijn Markaj dhe Dedë Tonaj; Shoqata Atdhetare "Dukagjini", në Shkodër, Njësite Administrative Shalë, Shosh, Pult, Temal e Shllak; Shoqata atdhetare "Dukagjini", në Miçigan, kanë vendosur t'i dhurojnë Bashkisë (qytetit) Shkodër, monumentin (bust), në mermer të Princit Lekë Dukagjinit, me përmasa: Monumentin (Busti)- 2 m dhe bazamenti 3 m, gjithsejtë 5 metra.

Lekë Dukagjini, krye heroi shpirtërore i shqiptareve as kund nuk ndihet me i lumtur se në Kryeqytetin shpirtërore të Shqipërisë, madje as në Ulpianën ku lindi, pasi herezia zhduku djepin dhe çdo gjurmë të rezidencës së tij.

Shkodra është dhe mbetet Kryeqendra e Leknisë, Lekë Dukagjini atlashe i tyre është figura më përbashkuese e nder krahinore dhe nder regjionale e gjithë Gegnisë

Mendja e ndritur e Lekë Dukagjinit, bazat e formimit i mori në Shkodër, e cila edhe në kohët më të errëta historike ka qenë një dritare perëndimore për Shqipërinë.

Sundimtari energjik, kapedani sy gacë, politikani dhe diplomati i shquar Lekë Dukagjini, kurrë nuk pati synime ekspansive ndaj Shkodrës, përkundrazi në ditët më të mynxyrat herezie të huaj luftoj me kordhe dhe zbythi nga qyteti forcat e frikshme osmane.

Dragoi i çartun prej kulshedërave nga fortësia e tij në Gur të Lekës pat lëshuar mallkimin, që drithëroi malet, ai po vjen i mirëseardhur në Shkodrën e Kulturës

Dukagjini i Shkodrës, është veç një kurmi i lisit të vjetër, që u zgjatën mbi truallin e Pultit në djepin e të cilit më vonë do të rritej e piqej Dukagjini i Ri, e vetmja

zonë që ruajti me fanatizëm emrin e vjetër dhe kryepincit të ndjerë. Pas shpërbërjes së Sanxhakut të Dukagjinit, ku u formuan disa treva të veçanta, Peja, Prizreni, Hasi, Luma, Mirdita, Puka e të tjera, Dukagjini i Ri mbeti në pjesën malore të Shkodrës, si mburojë dhe pjesë e saj.

Në administratën osmane ka qenë defakto pothuaj e lirë dhe veteurdhëuese sipas së drejtës tradicionale të Kanunit të Lekë Dukagjinit. Në kohën osmane është shkëputur nga diktati i Begollajve të Pejës dhe u bë aleati i përhershëm i Bushatlive të Shkodrës.

Lekë Dukagjini si figurë qendrore e historisë së mesme të Shqipërisë, është një oguri mirë për Shkodrën, pasi ai nuk mund të rrijë i vetmuar në kryeqytetin e Ilirisë pa i çelur portën Agronit. Teutës, Genci, e pse jo Kara Mahmut Bushtaliut, i cili e kishte për ndere se rridhte nga një dere e fisme Dukagjinase

Leka si figurë qendrore e historisë meriton një vend pushim në pjesën qendrore të Shkodrës dhe pikërisht, në Lulishten para Bashkisë tek (Shatërvani) aty ku nesër mund të jete një kompleks monumental figurash historike nga antikiteti e në vijim.

GRUPI

Mërgimtarët dukagjinës në Australi, Shoqata "Bashkësia shqiptare" (Itali), me kryetar Gjergj Temeli, Grupi investitorëve "Shaljanët për vendlindjen", në SHBA, të kryesuar Gjijn Markaj dhe Dedë Tonaj; Shoqata Atdhetare "Dukagjini", në Shkodër, me kryetar Ndue Sanaj; Shoqata kulturore "Besa-Shoshi", në Shkodër, me kryetar Ndoc Fusha; Njësite Administrative: Shalë, Shosh, Pult, Temal e Shllak; Shoqata atdhetare "Dukagjini", në Miçigan.

Shkodër, më 25 gusht 2022

Një vit pa ty, por ti gjithmonë midis nesh

E shtuna e 10 Shtatorit të këtij viti, për Shkodrën, Dukagjinin dhe gjithë njerëzinë, ishte si gjithmonë thjeshtë një ditë vjeshte. Por për familjen, të afërmit, miqtë, shokët dhe bashkëpunëtorët e “MJESHTRIT TË MADH” Mëhill Çun Gjonaj, ishte një ditë malli, kujtese e reflektimi në kujtim të emrit dhe veprës së tij, pasi pikërisht në këtë ditë të paharruar, u mbush plot një vit që artisti dhe “Mjeshtri i Madh” u nda nga jeta, duke lënë pas veprën e tij të madhe, të ndërtuar e skalitur me mjeshtri të rrallë e talent të pashoq, për më shumë se një gjysmë shekulli, mbi telat e çiftelisë, ndër skena dhe ekrane, në valët dhe frekuencat e Radio Shkodrës e Radio Tiranës, nëpërmjet të cilave, zëri i tij i ëmbël dhe zemra e tij e zjarrtë i kapërcyen kufijtë tokësor të Shqipërisë, edhe atëherë kur mendja e as këmba e ne të tjerëve nuk guxonin.

Mëngjesi i së shtunës së 10 Shtatorit 2022, në mjediset e Bar-Restorant “ORLANDO”, nisi me vizitat tradicionale familjare, nga të afërmit, farefisi, miq e të njohur nga Shala, Shoshi dhe gjithë Dukagjini. Por kjo ditë kujtese, ky njëvjetor i Mëhill Çunit, nuk u mbyll si gjithë njëvjetorët e përvjetorët e tjerë në Dukagjin, Shkodër, Malësi e Rrethina, të cilët zakonisht përfundojnë rreth orës 12’00, me një vizitë në varreza, një meshë të thjeshtë, a dy “rruzare” dhe disa tufa lulesh. Por atë ditë, njëvjetori i ndarjes së Mëhill Çunit nga jeta, ishte menduar disi ndryshe prej të tjerëve, sepse do të vazhdonte më gjatë, por tani jo me pritje e përcjellje!!

Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, në bashkëpunim me familjen, miqtë dhe bashkëpunëtorët më të ngushtë të jetës së tij artistike, organizuan një takim HOMAZH, kushtuar jetës dhe veprës, së “Mjeshtrit të Madh” Mëhill Çuni, ku pjesëmarrësit përveç shpalosjes së kujtimeve të një jete të gjatë të përbashkët në skenë dhe ekran, si dhe vlerësimeve që iu



bënë karrierës së tij gjysmë shekullore, u njohën edhe me stimujt, titujt dhe medaljet e akorduara ndër vite nga institucione, shoqata dhe organizata prestigjioze, që nga Urdhri “Naim Frashri” akorduar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor në vitin 1986, e deri tek urdhri i lartë “Mjeshtër i Madh” akorduar në janar të këtij viti nga PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË.

Për jetën dhe veprën e “Mjeshtrit të Madh” Mëhill Çuni, i pari që e mori fjalën ishte Kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” zoti Ndue Sanaj, i cili bëri një rezymë për gjithë jetën, veprën dhe karrierën artistike të “Mjeshtrit” Mëhill Çuni. Pastaj folën me radhë lahutari Kolë Gjoni e këngëtarët dhe instrumentistët e njohur: Fran Kodra, Kolë Hasani, Gjon Kosteri, Ndue Shytani, Pretash Nilaj e humoristi Gac Kodrina, dhe për t’u pasuar nga fjala mbresëlënëse e shkrimtarit dhe publicistit të mirënjohur Prelë Milani.

Duke i falënderuar për praninë dhe vlerësimin që i bëjnë emrit dhe veprës së babait të tij, Mëhill Çuni, në emër të familjes, pjesëmarrësit i përshëndeti edhe Oliver Gjonaj, duke i ftuar të kalonin së bashku një drekë të shtruar për nder të kësaj dite, aty në Bar-Restorant “ORLANDO”.

Veprimtaritë e kësaj dite të paharruar do të përmbilleshin mbrëmjen e asaj nate në ekranin e televizionit “KOPLIKU”, me dokumentarin e titulluar: “Fllad e këngë do t’ jesh për ne” dhe këngën e kënduar nga Nikë Çarku “Jeta jote këngë pa fund”!

Prandaj, edhe pse një vit i munguar, MËHILL ÇUNI, me zërin dhe zemrën e tij do të jetë gjithmonë midis nesh!

Poeti e publicisti Kadri Fikaj, Shkodër, shtator 2022

Kryqi që shikon Dukagjinin, Shala mrekullia e Alpeve Shqiptare!

Disa ditë më parë më kishte njoftuar profesori Luigj Shyti se në Alpet tona nga vëllezërit Nika do të vendoset një KRYQ madhështor me shikim nga lugina e Shalës e më përtej, sinqerisht e mirëprita këtë shkëlqim hyjnor në Dukagjinin tonë të dashur.

Dukagjini i shtrirë në gjirin e alpeve, i cili ngjitet në majën e tyre, në fillimin e bjeshkëve të Namuna (emërtesa e gojëkeqit), aty ku zanat fluturojnë lart përmbi luginën e Shalës drejt vendpushimit e bekimin për *forcën e përjetshme të Orës së Shalës*!

Thesari historik i identitetit tonë kombëtar e ka në pasurinë e vet emrin Dukagjin, pasi vetëm aty ndër shekuj u gjend besa, bujaria, mikpritja e qëndresa e përjetshme në përbashkësi me secilin mësymës ndaj territoreve e vataneve të tyre.



Dukagjini i shkollës së jetës së ashpër me kulla guri e jo me qerpiçë si fusharakët, me shtëpi me oxhak e jo me zjarr në vatër, aty ku të vegjlit dëgjonin të madhin, aty ku gruaja i bashkëngiitej si burmëshë burrit të fortë shqiptar, aty ku fjala ishte besatim njerëzor, edhe sot vetëm aty

yjet ndriçojnë më mirë.

Vetëm dukagjinasi janë kryelartësia e përjetshme, por shumë modest me secilin, ata kanë prodhuar histori kombëtare me burra kolosë e mendimtarë, e pasuar me intelektualë e shkencëtarë, e deri pasuria e artit e kulturës së djepit të kulturës shqiptare Shkodërloce!

Ata janë krenar me këto vende e trojet e tyre të vendosura deri në lartësinë mbi 2600 m, ata janë nacionalistët më të shëndoshë e më të fortë të kombit shqiptar.

Para dy ditësh dukagjinasi i nderuar Anton Bobnaj më nisi lajmin me disa video se në Majën e Zorjës u vendos kryqi 12 metra i gjatë, i cili shikon Shalën e më përtej.

Menjëherë unë kontaktova edhe duke uruar mikun tim Luigj Shyti, i cili ndodhej në Itali, Ai më konfirmoj vendosjen e kryqit

në një maje në terren të vështirë, duke më saktësuar se janë vëllezërit Zefi, Pjeteri e Deda Nika, të cilët kanë mundësuar këtë KRYQ në tokën dardane i vendosur në Majën e Zorjës, e cila regjizohet me helikopter nga Qafa e T’thores-Thethi ynë piktoresht, kjo edhe me kontributin e Sokolit – i biri i Zef Nikës, i cili jeton në Amerikë!

Për vëllezërit Nika, të cilët bëhen pjesë e pasimit, pasurimit të brezave të tyre në përjetësimin e identitetit tonë kombëtar, të cilët ngjiten KRYQIN në 1600 metra mbi nivelin detit e me ndriçim të përherëshëm, tani na mbetet urimi njerëzor: Zoti ju bekoftë familjarisht, për këtë dhuratë hyjnore në Alpet tona!

Me bindje po e mbylli, duke paralelizuar Kadarenë: “Po heqësh shqiptarëve katoliçizmin dukagjinasi, kombi mbetet pa palcë kurriore!”

Nga Agron PREBIBAJ

NJË VIT MË PARE!

MHILL ÇUNI, NJË MUNGESË QË VAJTON NË TELA TË ÇIFTELISË KU SHPIRTI I TIJ KËNDOI NJË JETË

Iku një vit, që kur u nda nga jeta artisti, këngëtar, instrumentisti, kultivuesi i këngës folklorike, zëri i veçantë dhe biri i Dukagjinit, Mhill Çuni. Vdekja e parakohshme e një personaliteti të tillë të traditës së këngës folklorike dhe jo vetëm, ishte një humbje e madhe për artin burimor, për vlerat e përfaqësimit të talentit dhe kontributit. Mhill Çuni na la pas pasurinë më të madhe që njih folklori dukagjinasi e më gjerë. Autori i qindra teksteve dhe këngëve që këndohen në

mbarë Shqiptari, këngë që janë pjesë e gëzimeve familjare dhe trashëgimisë sonë shpirtërore.

Një zë dhe një korpus krijues, një virtuoz i instrumentit dhe një shpërthyes i vargut si Mhill Çuni, mund të shuhen këso jete, por nuk mund të vdesin, sepse nuk ka vdekje për atë vlerë që gatoi me shpirt e pasion, pasurinë tonë të këngës.

Zëri i tij do të jetë i gjallë mes nesh përmes këngëve hit, "Pavarësia" "Këngë për Qerim Delin", "Kjo Shqipni qe e njeh gjithë Bota / Kurr nuk rrin pa Kastri-



ota", "N'at Pranvere kur u shkri Bora", e të tjera. Emblema të krijimtarisë dhe interpretimit të tij do të mbeten, siç do të mbetet i pashuar edhe lavdia që ka ngritur ai me shumë punë dhe shumë përkushtim.

Lë të sjellim si homazh në këtë ndarje një dedikim që bashkëpatriotit të tij, Prele Milani, kushtim në vargje dedikuar Mhill

Çunit: Një çifteli jehon në male, / vallëzojnë bjeshkët dora-dora, / thërrasin hitet rrezatuare, / Këndo Mhill Çuni të lumtë goja! / Por si bleta mbi petale, / në çdo fushë, kodër e mal, / 50 vjet mblodhe thesare,

Rrofsh e qosh o gjeneral!

E kush më mirë se ai do ta përjetësonte në vargje dukagjinasi, Mhill Çuni, veç Prel Milanit. Vargje të tjera janë thur e do të thuren për Mhill Çunin, sepse nuk është vetëm ai që shkruan dhe këndon për të tjerët, janë edhe të tjerë që do të shkruajnë dhe këndojnë për të në tela të çiftelisë e në hark të lahutë, sepse Mhill Çuni ishte vlerë dhe vlerat kanë përjetësuar emrin e tyre në vepër që meriton vëmendje, vlerësim dhe mirënjohje.

Zani i Malsisë

Mhill Çun Gjonaj, i pavdekshëm emri e vepra e juaj!

(FJALA PËRKUJTIMORE, ME RASTIN E NJË VJETORIT TË NDARJES NGA JETA TË MHILL ÇUN GJONAJ)

Të nderuar të pranishëm!

Jemi sot këtu për të nderuar jetën e veprën kantautorit të veçantë të Dukagjinit, Mhill Çun Gjonaj!

Për ju, Pali e Fran Çuni, vëllezër të Mhillit!

Për ju, Lorenci e Oliveri, djemtë e Mhillit!

Për ju, Kristjana, Dranila, Valuta, Krajllica, vajzat e Mhillit!

Për ju, Sofie, Marie e Bardha, motrat e Mhillit!

Për ju të afërmeve e miqësi të Mhillit!

Për ju pjesëmarrës në këtë përkujtimore!

U bë një vit, që Mhillin nuk e kemi në mesin tonë! Ja pra, ikin ditët, ikin javët, ikin muajt dhe bëhen 12 muaj, që kantautori i veçantë e vështirë të arrihet, Mhillin tone!

Kush ishte Mhill Çun Gjonaj?

Mhilli, lindi me 18 shtator 1950, në fshatin Nica, të krahinës së Shalës në një familje të nderuar në Dukagjin, Çun Nika e Drane Markja

Shkollën fillore e 8 vjeçare i përfundoj në fshatin e lindjes. Pastaj vijoj shkollën e mesme për veterinar, në shkollën Profesionale Veterinare – Shkodër. Por ai, kishte një dhunti në një fushë tjetër, në atë të folklorit dhe jo vetëm për të kënduar, por dhe për të krijuar tekste të veçanta për kohën. Pra, Mhilli u bë rapsod dhe kantautor më me emër në gjitha trevat shqiptare:

Kryerapsodi i Dukagjinit më i spikatur i të gjitha kohërave dhe pa dyshim një nga zërat më autentik të çiftelisë në shkallë kombëtare.

Mhilli, ishte një mriz me rrënjë të thella në folklorin shqiptar. Ai ishte nipi i Gjergj Mark Gurit dhe Kolë Mark Gurit- Laruat Kombëtarë, njeri në Shkodër dhe tjetri në Lezhë. Zëra të hershëm të radiofonisë shqiptare. Ndërkohë që gjyshja e tij, Zojë Mustafja ka qenë një nder vajtoresh me klasike të maleve Shqiptare. Ajo ka mahitur At' Shtjefen Gjeçovin dhe At' Benardin Palajt, të cilët i referohen në studimin e tyre në fushën e folklorit.

Mhilli, ishte një talent i lindur me dhunti specialë, poetike, vokale të kristaltë, një zë sa kumbues aq të ëmbël që u bë e mbeti bashkëshoqëruesi më i mirë i perlave poetike, që i buronin nga zemra duke i rritur

e kthyer në hitet më të dashura për veshin e zemrat e miliona shqiptarëve.

-Mhilli, u rritë së bashku me çiftelinë dhe në skenën e shtëpisë së Kulturës Breg Lumi, në të cilën ka kënduar që në moshën 8 vjeçare.

Mhilli, mjeshtër autentik i majave i dha flokut burimor jehonë në gjithë hapësirën mbarë shqiptare, për mes valëve të "Radio Tiranës"; "Radio Tiranës për shqiptaret jashtë atdheut" e RTVSH. Ai ka marre pjese në qindra, koncerte e manifestime folklorike në skenat brenda dhe jashtë atdheut, kudo që jetojnë shqiptaret, ndoshta si as kush tjetër në Zonën ku kumbon çiftelia janë memorizua në arshivën e flokut hite kombëtare të pavdekshme 20 këngë, që nga kënga -"Pret Stambolla Skënderbeun" e deri te kënga "Ka je nisë Turgut pasha".

Repertori artistik i tij përfshinë mbi 250 kënge.

Mhill Çuni nuk ishte thjeshtë një rapsod, por së pari një poet i talentuar dhe duke qenë i tillë është nder Kantautorët e pare dhe pa dyshim më të talentuarit e kohës së tij.

Ai ka marrë pjesë në festivalet Folklorike Kombëtare të viteve 1978, 1983 e 1988. Në vitin 1982 kur ishte në Shtëpinë e Kulturës Breg Lumi, në bashkëpunim

me muzikologun Robert Prendushin dhe Përgjegjës të Kulturës Gjergj Çuni zbuluan dhe vunë në skenë Vallen burimore "T' Lekve", e cila shkoj dhe mori çmim kombëtarë në Gjirokastrë.

Në vitet 1981-1990, drejtues i jetës kulturore e artistike në Gruemirë, Malësi e Madhe.

Në vitet 1999-2002, ideator dhe drejtues i spektaklit "Hitet Folklorike" në TV1 Channel, Shkodër.

Themelues dhe drejtor artistik e kulturor "Sofra e Dukagjinit".

Për këto vlera është nderuar me tituj nderi:

Në vitin 1983 dhe 1988, është fitues Laurat i festivaleve folklorike;

Në vitin 1996, fitues i çmimit "Rapsodi më i Mirë", në Takimin Kombëtar të Lahutarëve, në Lezhë.

Në vitin 2017, 'Qytetar Nderi' i Komunës Rrethina, Shkodër.

Në vitin 2017, nderuar nga Shoqata Atdhetare "Dukagjini", me titullin "100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin"

Në vitin 2019, Çmimi "Krenaria e Sofrës së Dukagjinit".

Me 20 janar 2022, nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me propozim të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", është dekoruar me urdhrin "Mjeshtër i Madh".

Mhill Çuni Gjonaj, është ndare nga kjo jete, por ka lenë të gjallë e të pavdekshme këngën e tij, emrin e nderuar siç e kane cilësuar "Krushku i pare i çiftelisë"!

Në emër të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" dhe në emrin tim, vëllezërve, motrave, vajzave e djemve, ju uroj: "Kjofshi me jete të gjatë e ta kujtoni Mhill Çun Gjonaj!"

Të gjithëve, të afërmeve, kolegeve e miqësisë ju urojme: "Pacën jetën e ta kujtojmë kantautorin Mhill Çun Gjonaj!"

Mhill Çun Gjonaj, i pavdekshëm emri e vepra e juaj!

Ndue Sanaj,
Shkodër, më 10 shtator 2021



LAHUTARI I EPOSTIT TË KRESHNIKËVE

Jonuz Delaj është lahutari më i veçantë në trevën e Malësisë. Një vazhdues i gjallë i traditës, historisë dhe krenarisë së lashtë të Eposit të Kreshnikëve. Prej 64 vitesh Jonuz Delaj nuk resht duke i kënduar e shkruar këngë Malësisë, historisë së saj të lavdishme, traditës, kulturës e personazheve më të rëndësishëm në shekujt e gjatë të Malësisë. Jonuz Delaj në moshën 6 vjeçare filloi ti binte lahutës, në një moshë kur lahuta ishte më e madhe edhe se vetë artisti. Këtë instrument muzikor e ka trashëguar nga babai dhe gjyshi që ishin mjeshtër të lahutës. Lahuta dhe pushka ishin binom i çdo familje malësore. Fëmijët në atë kohë bëheshin ose të pushkës ose të lahutës. Fëmijëria e Jonuz Delajt ishte e lidhur jashtëzakonisht me kuvendet e burrave, logun apo organizimet mes fshatrave. Fisnikëria e malësorëve ishte e jashtëzakonshme. Dashuria për atdheun ishte frymëzim së bashku me këngët e trimërisë, lufta për të mbajtur pushtuesin (shkjaun) larg trojeve shqiptare. Krenaria e të papushtuarit, dëbimi i shovinistëve dhe mbajtja në mënyrë të shenjtë të tokave të të parëve, ishin elemente dallues dhe frymëzues në këngët e Jonuz Delajt.

Kënga e parë e kënduar prej lahutarit Jonuz Delaj quhet: “Këta nizamët e shqiptarisë” që i dedikohet djemve shqiptarë të marrë peng prej Turqisë. At Gjergj Fishta ishte element frymëzimi për çdo malësor. Jonuz Delaj në moshën 10 vjeçare lexoi kryeveprën e Fishtës “Lahuta e Malësisë” origjinale dhe arrinte të thoshte qindra vargje në koncerte e ansamble. Jonuz Delaj është dekoruar me Dekoratë e Klasit të Tretë nga Kuvendi Popullor si interpretues i vlerave kombëtare, folklorike dhe trashëgimisë kulturore. Kënga e fundit që ka krijuar lahutari Jonuz Delaj është për emigrantët shqiptarë e titulluar: “Prej mërgimit më erdhi një fjalë”. Jonuz Delaj vazhdon të krijojë çdo ditë duke i kënduar Malësisë, figurave të saj, e ngjarjeve më të rëndësishme të historisë së saj. I harruar prej të gjitha pushteteve, ai nuk u zemërua kurrë, por në zemrën e tij dhe shpirtin të artit kultivoi dashurinë për Malësinë e tij, atë që nuk e braktisi kurrë. Çdo këngë ka historinë e saj të veçantë tregon Jonuz Delaj. Pabesia e komunistëve ndaj Kelmendit ishte e frikshme. Kelmendasit janë mësuar gjithmonë me pabesi që nga Osmanët e deri nga serbët e komunistët në fund, shpreh pikëllim lahutari. Jonuz

Delaj i ka kënduar Marash Ucit (një figurë e lartë trimërie nga Brigjet e Hotit), Oso Kukës, Atë Fishtës, Ciklit të Kreshnikëve, Martesa e Halilit, Isa Buletin, Ali Pashë Gucinë, Nores së Kelmendit, Mem Smaljit, Prek Calit, Nik Lek Pepës, Sali Manit etj. U ka kënduar ngjarjeve që kanë shënuar Malësinë, qëndresës heroike



e tij ushtoi sa bjeshka / Atje në Londër ky dai / Mos mi shtyj gur e shefi / Mos ma shkelni vendin tem / Se ua baj vorrin në Kelmën

Sipas Lahutarit Jonuz Delaj, At Fishta erdhi në Malësi jo vetëm për meshën e shenjtë, por edhe për ti kënduar e shkruar malësorëve të Malësisë, bijve heroikë dhe



të Kelmendit çka e bëjnë këtë lahutar kaq të dashur për Malësinë e malësorët.

Leu Prek Cali mbi këto kreshta / Fjala

atyre që kanë lënë jetën për Kelmendin e krejt Malësinë. Fishta u shkroi malësorëve dhe fisnikërisë e trimërisë së tyre mbi 20 mijë vargje. Lahuta ime thotë Jonuz Delaj, nuk i ka kënduar gjithëkujt, por bijve të veçantë të Malësisë dhe historisë së saj. Lahuta është më e vjetër se Cikli i Kreshnikëve. Lahuta ishte një sinjal kushtrimi si kënga maja krahut për raste të veçanta për malësorët që të mos diktoheshin nga shkjaun. Kënga e lahutës dhe kënga maja krahut ishin sinjale të veçanta komunikimi, një gjuhë specifike e fshehtë mes malësorëve që sinjalizonin njëritjetrin në raste rreziku. Edhe në komunizëm nuk i këndoi kurrë partisë dhe udhëheqjes por vetëm Ciklit të Kreshnikëve dhe trimërisë e historisë së Malësisë e malësorëve. Vetë misioni dhe specifika e lahutës si instrument muzikor e shpëtoi nga censura dhe shërbimi ndaj partisë e udhëheqjes së kohës. Lahuta i këndonte trimërisë së malësorëve, kënga e lahutarit frymëzonte malet dhe malësinë

e trimërinë, i nxiste në luftë patriotët për të luftuar për atdheun e trojet e tyre. Në çdo luftë, në çdo kuvend burrash, në çdo betejë, lahuta i frymëzonte malësorët kundër sllavëve dhe osmanëve. Çdo katund ka pas lahutarët e tij në Malësi. Lahuta, fyelli, zymarja ishin tre instrumentet muzikor më të përdorur në Malësi. Jonuz Delaj veçon lahutarët më në zë të Malësisë: Nua Biboçi, Prek Gjon Luca, Martin Llesh Smajlaj, Vera Qosaj, Pretash Nilaj e disa të tjerë që e kanë trashëguar traditën e lahutës në Malësi. Sipas Jonuz Delajt, Sali Mani solli i pari çiftelinë në Malësinë e Madhe dhe i këndonte fshatit, trimërisë së malësorëve, jetës së përditshme dhe personazheve të thjeshta frymëzuese të jetës së përditshme. Së bashku me Sali Manin kujton lahutari Jonuz Delaj, shkollim nga Malësia në Shkodër në këmbë për të kënduar në koncerte. Ne lidhëm një miqësi të fortë. Si dy instrumentet e çiftelisë e lahutës që janë bashkë, ashtu edhe ne ishim një binom i pa ndarë. Me Sali Manin kemi shkuar në çdo festival në Gjirokastër, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e të tjera. Fakti i qëndrimit besnik të boshtit kreshnik të Lahutës, shpjegon lahutari Delaj, më shpëtoi nga kënga për udhëheqjen komuniste. Jonuzi i rritur me sokolat e bjeshkës mësoi ti binte edhe fyellit, zymares e çiftelisë.

Lahutari Jonuz Delaj ka qenë pjesëmarrës i festivaleve ndërkombëtare në vitin 1973 në festivalin Ballkanik në Ohër të ish-Jugosllavisë, në Ankara të Turqisë, në festival Evropian në Venecia, në Bolonja dhe turne të rregullt në viset shqiptare të Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi e Preshevës. Lahutari Delaj tregon me krenari se në Prishtinë, vitin që shkoi së bashku me lahutarët të tjerë kanë krijuar Festivalin e Lahutarëve në hapësirën mbarëshqiptare. Lahutari Jonuz Delaj është një mbrojtës i flaktë i vlerave të hershme të lahutës (lavdës) në media të shkruara dhe audiovizive. Lahutari Jonuz Delaj sulmon dhe UNESCO-n që e ka cilësuar lahutën element të trashëgimisë kulturore serbe. Lahutari Delaj citon At Fishtën: Serbët në Ballkan erdhën dy shekuj mbas nesh dhe shprehimisht, kur ne vazhdonim qytetërimin për dy shekuj, ata erdhën nga shpella Urale të Rusisë.

Në 30 vitet e demokracisë janë vitet më të zymta të artit dhe kulturës shqiptare. Sidomos të pjesës folklorike që përbën identitetin tonë kombëtar, shprehet i zhgënjyer lahutari Delaj. Tradita dhe historia në muzikë është lënë në harresë prej qeverive në vazhdimësi. Shteti duhet ti ruaj me fanatizëm këto tradita. Sot ky komb është në rrezik, po humbet identitetin kombëtar. Që nga librat në shkolla e deri te mbështetja shtetërore për artin janë në nivele alarmante. Nuk kujdeset askush as për individin as për artin, nuk ka kinema, shtëpi kulture, zero investime për artin. Në përfundim të bisedës, lahutari kreshnik Jonuz Delaj, na lë një amanet patriotik: Ruani patriotizmin siç e ruani prej më shumë se tash një shekulli. Mësojini fëmijëve shqip. Duani atdheun dhe mos e harroni kurrë historinë dhe identitetin tuaj shqiptar.

Sokol PAJA - DIELLI

AMANETI I FUNDIT

Fli bir gjumi me andrra të bukura të pastë nana
U bafsh njeri i mirë, i ditun dhe zemërgjanë
Ditën që linte me dorën e saj të pagëzoi Hana
Me ujin e burimeve që ndodhen në këto anë.

Erdhi një ditë që vogëlushi u rrit u ba burrë
Nga zona e Temalit zbriti në qytetin e Shkodrës
“Po largohem vendi im, nuk do të shoh ma kurrë!
Jam, gjaku i Arbrit i dha jetë Evropës.”

Katedra e Albanologjisë e Universitetit të Mynihut
Profesor doktor Martin Camaj lider në vite
Gjuhën pa pushim e shkriu talenti i tij prej gjeniu
Për ta përzije në “magjen” e vlerave të mëdha artistike.

‘Dranja’, ‘Rrathët’, ‘Midis dy motëve’, ‘Karpa’
Ka margaritarë të tjerë gjiganti i letërsisë tonë
Në pyjet e bjeshkëve të nalta e ka folenë Shqipja
Në kontinentin e vjetër asaj i bani jehonë.

Amaneti i fundit: “Mos harroni qelshen e bardhë
Edhe atje në Qiell do ti shërbej jetës”
Nuk trembet malësori të vijë kur të dojë me ardhë
Dhashë çdo gja për njerëzit, kombin e të vërtetën.”

Luigj Temali, Shkodër, 22 Shtator 2022

Përrurimin e Kishës së re në Curraj të Epërm

Fjala Përshëndetëse e Skënder Përpepaj

Të nderuar vëllezër e motra!
Të dashur pjesëmarrës!

E nderuara Ministre e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë të Republikës së Kosovës, znj. Rozeta HAJDARI!

I nderuari deputet në Kuvendin e Shqipërisë, z. Lavdrim KRASHI, që e latë Londrën për të shërbyer e kontribuar për Dibrën e Shqipërinë!

I nderuari Kryetari i Këshillit të Qarkut të Kukësit, z. Abdulla DOMI!

I nderuari Kryetar i Bashkisë Tropojë, z. Rexhë BYBERI!

I nderuari Kryetar i Bashkisë Pukë, z. Gjon GJONAJ!

Të nderuar ambasador Flamur GASHI dhe gjeneral Dedë PRENGA!

I nderuari Kryetar i Njësisë Administrative të Nikaj-Mërturit, z. Ndue GJERGJI!

I nderuari Kryetar i Shoqatës së Nikaj-Mërturit, z. Gjin PROGNI!

I nderuari Kryetar i Shoqatës për Promovimin e Turizmit Malor të Kosovës, z. Skënder THAÇI!

Mirë se erdhët në Curraj të Epërm, në një nga 115 fshatrat turistike të Shqipërisë!

Në këtë ditë të përrurimit të Kishës tonë të rikonstruktuar tërësisht me kontributin monetar e shpirtëror të bijve të saj në Diasporë; edhe në këtë rast të vazhdimit të pandalur të promovimit të vlerave historike, kulturore e turistike të fshatit tonë, në të cilin po rikthehet gradualisht ri-popullimi pas shpërnguljes së 30 viteve të fundit dhe ka nisë e po gjallnon jeta e ardhmëria e tij, me bashkëvendësit tanë, me turistë të huaj, dhe me Jumiqtë e nderuar, të ftuar, në këtë "Mrekulli të Alpeve Shqiptare". 125 vjet më herët, pikërisht në vitin 1897, përfundoi së ndërtuari Kisha e Currajve të Epërm, me përkujdesjen e veçantë të Perandorisë Austro-Hungareze, e cila ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për Katolicizmin e institucionet e tij në Shqipëri, për Pavarësinë e Shqipërisë.


Ndërtimi i kësaj kishë ka pas kontributin edhe të banorëve tanë vendas, besimtarë të përkushtuar, të cilët para ndërtimit të saj apo dhe në ato raste kur mungonin famulltarët, udhëtonin me nga 10 orë në këmbë

për të pagëzuar fëmijët e tyre, për të kryer rite fetare, në Kishën e Nikajve e në ato të Dukagjinit. Kisha e Currajve të Epërm, prej ndërtimit të saj, edhe tani pas rikonstruksionit të plotë të saj, me shenjtërinë e saj të lartë, ka qenë dhe do të mbetet shpirti e pika jonë e takimit vllaznor, besimtar e atdhetar; vendi i pagëzimit dhe i përcjelljes

së të dashurëve tanë për në banesën e fundit; vendi i lidhjes së miqësive, martesave, pajtimit dhe besatimit për çdo gjë e për të gjithë besimtarët e saj.

Kisha e Currajve të Epërm ka shkruar historinë e saj, ka hyrë në historinë e kombit shqiptar, me ngjarjen historike të së dielës të 4 korrikut 1915, kur një komando ushtarake malazeze, arriti deri në qendër të Currajve Epërm, e për siguri u ngujua brenda në Kishë. Banorët e fshatit tonë, si besimtarë të zellshëm që ishin dhe janë, nuk pranin të gjuanin plumba mbi derën dhe as mbi dritaret dhe muret e kishës. Në këtë situatë të pazakontë, famullitari i Kishës së Currajve të Epërm, At Leonard Shajakaj ka dalë jashtë kishës e ka marrë kontakt me përfaqësuesit e popullit të Currajve të Epërm, të cilët kanë refuzuar me indinjatë kërkesat e ushtarëve malazezë. Sikurse dihet, në vazhdim të kësaj bisede, paria e Currajve Epërm, ka kërkuar ndihmën dhe shpjegimin fetarë të famullitarit për të nxjerrë shkijet jashtë nga kisha, për ti çarmatosë e më pas për ti përcjellë deri në Mal të Zi.

jën e vjeshtës së vonë në Qafë të Kolçit e të tjera. Kryesisht në Kishën e Currajt të Epërm si dhe në kulla të malësorëve të fshatit tonë, At Bernard Palaj e At Donat Kurti i mbledhën e përgatitën për botim një pjesë të madhe të Eposit të Kreshnikëve, të cilat u botuan tek "Visaret e Kombit", Vëllimi i Dytë, në vitin 1937, ku, këta dy misionarë të fesë e kulturës kombëtare, shkruajnë, aty, se: "Rapsoditë më të bukurat, si për kah veshja poetike, si për kah lidhnija e argumentit, këndohen ma fort në Curraj t'Epër, në Mërtur e në Dukagjin". Ky, Eposi ynë i Kreshnikëve, i mbledhur dhe në Curraj të Epërm, është proevropian, është në ngjashmëri, vlera e pasuri kombëtare sikurse dhe eposet e kombeve e shteteve më të mëdha të Evropës së sotme; është trashëgimi e madhe e brezave shqiptarë dhe kulturës e historisë sonë. "Eposi i Kreshnikëve", "Kanga Maje-Krahu", "Gjama e Burrave", Xhubleta, Lahuta, Plisi i Bardhë janë pasuri tipike e historisë e kulturës edhe të Currajve të Epërm, të cilat po synohet të jenë Trashëgimi Botërore e UNESCO-s, të



Në bisedë e sipër, famullitari At Leonard Shajakaj, sipas dokumenteve historike kishtarë, ju ka thënë burrave të Currajve: "A po ndieni burra në këtë raste nuk asht mëkat me qitë kundra kishës..., pse meshtarë aty s'ke, por ka hi aty ai qi kjoftë tretë (shejtani), pse këta s'janë tjetër veçse të mallkuem, e prandaj duen qitë jashta kishet". Pas fjalës së famullitarit, ndërkohë që malazezët nuk u dorëzuan vullnetarisht, ka krisë pushka, ka nisë lufta, aq sa edhe sot në gurët e mureve të kishës, duken shenja të plumbave të asaj betejë. E, sipas Zakonit "të ndores" i përcollën deri në afërsi të qytetit të Gucisë. Kjo i shndërroi asokohe Currajt e Epërm në një hapësirë të lirë në hartën e zaptimit e sulmeve ushtarake malazeze me zjarr e hekur në Malësinë e Gjakovës me rrethina, i shtoi përgatitjet luftarake dhe i frymëzoi më shumë luftëtarët e fshatrave e krahinave për Bete-

merren në mbrojtje prej saj. Kisha e Currajve të Epërm, në historinë e vet ishte një institucion fetar e shkollor, është ndër të rrallat e të vetmet në Shqipëri, që mbijetoi në kohën e komunizmit, i shpëtoi pushtimit ateist komunist të vitit 1967, sepse besimtarët e saj në këto troje plot lavdi e bukuri, me zgjuarsinë e tyre ditën dhe mundën ta bindin të Deleguarin e Komitetit të Partisë të rrethit dhe autoritetet lokale qendrore të Tropojës, për të mos e shembur kishën, por për ta kthyer atë në një muze të kujtesës historike, në funksion të kulturës.

Zëri popullor i Currajve të Epërm, fjala e një prej përfaqësuesve të tyre të zëshëm, ishte: "Partia ka vendosur ti shembë kishat, por kjo e jona mendoj të ruhet si qendër lufte e rezistence ndaj serbo-malazezëve, të shndërrohet në shtëpi kulture e zyra për pushtetin popullor". E, pas kësaj, ky objekt fetar, nuk u shkatërrua nga themelet, si të tjerat në të gjithë Shqipërinë, por u kthye në shkollë fillore dhe në zyrë të administratës së fshatit Curraj i Epërm. Kjo ishte meritë e popullit të Currajve të Epërm, të cilët me besim në Zot e Traditë, arritën të ruajnë godinën e Kishës dhe disa prej objekteve të saj të shenjta si truporen e

DERI KUR?!



Përgatiti Ndue Ziçi

Ne jemi të ndërgjegjshëm për krizat, të cilat kanë përfshirë pothuajse gjithë botën. Lufta në Ukrainë ka goditur më rëndë Evropën, brenda së cilës jemi edhe ne. Kuptohet, ne jemi një vend i vogël, por resurset i kemi të mëdha, kjo falë zemërgjerësisë të Perëndisë, që është treguar aq bujar me Shqipërinë. Ne kemi fusha, male, dete, lumenjve, burime ujore, pasuri të pafundme minerare e të tjera. E me të gjitha këto, ne jemi vendi më i varfër në Ballkan, Evropë dhe rreshtohemi me vendet e varfra në botë.

Në retorikën e përditshme trumbe-tohen me të madhe arritjet jo reale në ekonomi. Duke bërë krahasime me disa vite më pare. Në mendje të rrokullisën fjalimet e dikurshme, ku krahasoheshim me rezultatet e vitit 1938. A thua se shkenca, teknika, njerëzit janë në vend numëro. Jo, jeta ka avancuar, duke ecur shumë përpara. Për të mbuluar të metat dhe korrupsionin, krimet fajin ua hedhim tërmeteve, pandemie, luftërave në botë e s' fundmi asaj në Ukrainë. Këto fatkeqësi a thua se nuk kanë prekur vendet fqinjë, por kanë goditur direkt Shqipërinë. Jo, jo, shtetet fqinjë mendojnë për të ndihmuar në përballimin e krizës. Kryesisht shtresat

në nevojë siç janë: Pensionistet, invalidët, familjet me përkrahje sociale e të tjerë.

Nuk kemi pse të largohemi se Kosova i jep çdo pensionisti 100 euro në muaj, studentëve dhe shtresave në nevojë po të njëjtën vlerë. Kur për tre muaj qeveria Rama dha nga 26 euro. Madje kur ishin dy pensionistë në një shtëpi, këto 26 euro i përfitonte vetëm njëri se tjetri nuk do hante. Duke pare se u pasuruan shtresat në nevojë, i ndërpreu!!! Tani bëri një rritje pensioni me 6 për qind, me një llogari të thjeshtë. Një pensionit që merre 20 000 lekë në muaj, shtesa është 1 200 lekë ose 40 lekë në ditë. Asnjë kafe në rrugicat e lagjes se në qendra të qyteteve duhet me t'i shtosh dyfishin e ujin ta marrësh me vete. Kur pensionistet dhe shtresat në nevojë, prisnin që rritja të fillonte me një shtator, buzqeshja ju ngriu në buzë. Joo, jo shtesat do fillojnë me një tetor!!! Kur çmimet e shportës kanë shkuar në stratosferë, inflacioni galoponte, nafta më shtrenjtë se në Gjermani, Francë e Itali.

Deri kur?!

A e shohin punonjësit e kufirit e të doganave në vendkalimet kufitare se sa makina kalojnë në, Muriqan, Han të Hotit, në Morinë, në Bllat, në Qafë Thanë e të tjera. Vetëm për tu furnizuar me karburant e artikuj ushqimor, Qeveria duhet të mendojë si përballohet jeta mbi 70 % e popullsisë e ku afërsisht pas emigrimit të rinisë, 50 % janë pensionist. Mbase, qëllimi është që këto pak vite, që ju kanë mbete ti kalojnë në skamje. Përveç energjisë, ujit, e detyrimet ndaj shtetit do blejnë ilaçet, të cilat varojnë nga 6 000 deri 10 000 leke në muaj. Flitet se ilaçet janë rim-

bursuar, kur dihet se mjeket thonë: "A keni ndonjë të afërm në Itali ose merri të shtrenjta"! Të rimbursuarat janë me cilësi të dobët! Falë remitancave se laku në fyt do të shtrëngohej edhe më shumë.

Le t' i referohemi Kosovës se, si ka vendosur të përballojë krizën e personave në nevojë. Të gjithëve u jep nga 100 euro në muaj, madje ndihmon edhe biznesin e vogël. Të ndalemi te pensionistet, të cilët janë në numër me të lartë në krahasim me shtresat e tjera në nevojë. Po sikur shteti të japë nga 50 euro. Shifra do të arrijë afërsisht 33 500 000 euro në muaj. Dhe për 4 muaj do arrijë në 134 000 000 euro. Këto fonde me një vullnet të mire janë plotësisht të realizueshme. Duke ulur shpenzimet e luksit, siç janë udhëtim e dieta, ndërtesa apo ngrehina për të kullotur sytë. Vetëm po të zbatoheshin detyrat KLSH kjo nuk do të bënte asnjë sforcim. Gjobat që merren nga arbitrazhet të mos paguhen nga taksatona. Vetëm me parat që merre "Bagëti" siç deklarojnë mediat do të përballohej kjo paketë. Nuk kemi nevojë për akademi për barinjët, as për 130 euro që nuk i dalin një familje në muaj! Ma do mendja se, as për tu lare vet as rrobat. Një pensionist tha, se na kthyen ne mesjetë, se atëherë lahashin vetëm dy herë në vit. Për Pashkë e Bajram se herët e tjera të lante Perëndia. Tani do na lajë qeveria.

Deri kur?!

Këto retorika nuk i ha askush. Mbështetje duhet dhënë edhe studentëve, me qellim që të vazhdojnë normalisht studimet. Kështu veprohet jo vetëm në vendet e BE-së, por edhe rrotull nesh. Qeveria para se të japë këshilla, duhet të ulet e të bëjë studime e të gjejnë rrugët për lehtësimin e krizës. Me qellim që krizën ta kalojnë sa më lehtë shtresat në nevojë. Kjo për mbi 80 % të popullit, madje duhet pare mundësit e uljes së investimeve në disa sektorë, të cilat nuk

janë emergjente. Perse nuk përcaktohet minimum jetik? Kujt i intereson të mos dihet kjo?!

Për problemet e pensionistëve, nuk ka një ndërgjegjësim të shoqërisë. Madje mungon respekti për këtë shtresë, sikur nuk do të kalojnë të gjithë në këtë kapërcyell. Pra, edhe ata që janë të rinjë ta mendojnë se do të dalin një ditë në pension. Themi se, TV lokale e ato qendrore, duhet të bëjnë ndonjë emision për të moshuarit, për ato mori problemesh që kanë. Për çfarë nuk diskutohet në opinionet, probleme nga më të ndryshmet. Ka edhe analiste pensioniste, por jo me pension kooperative apo minimale, po me pensionin disa fish më të larta, se vijnë nga ish deputet apo zyrtarë të lartë të partive të ndryshme. Ka nga ata që kanë marrë pjesë në disa parti. Duke ndërruar petën e lakrorit sipas interesit, sa kanë arrite të bëhen si galloshet shumë përdorimesh. Por asnjë fjalë nuk e thonë për këtë shtresë. Madje bëjnë policinë, prokurorin, gjykatësin, arrestojnë, ekstradojnë deri sa sipas tyre, japin mend SHBA-së, BE-së e të tjera. Me ato teza që shtrojnë, nuk i shërbejnë askujt, se për të mos thënë se kanë rrjedhë nga koka, po jemi të bindur se janë radhuar. Para se të merresh me gjithë njerëzinë, thuaje një fjalë për moshatarët e tu.

Përsëri, deri Kur?!

Pensionistet duhet të angazhohen, organizohen në shoqata të paktën në çdo qytet pa dallime partiake, po vetëm për problemet e tyre, të cilat janë të shumta. Të bëhemi një zë i fuqishëm, pse jo edhe oponencë me çdo qeveri që vjen në pushtet, për paudhësi e tyre të pa ligjshme. Por jo kurrë si sindikatat, të cilat i bëjnë vetëm fresk qeverisë e që drejtohen nga Nikolla e Kalaja. Jemi ngopur me dromca, me pikatore.

DERI KUR?!

Shna Ndout e Kryqat, e të tjera, të cilat, pas vitit 1991 të rihapjes së saj iu kthyen kishës.

Gjashtë Gushti i sotëm i përrurimit të Kishës, është një ngjarje e madhe historike për Currajt e Epërm, pasi në 125 vite të saj (1897-2022) nuk i është bërë asnjë rikonstruksion dhe investim i tillë, i këtyre përmasave plotore, të mëdha, me ndërhyrje në mure, dyer, tavane, çati e të tjera, janë dhe objekte të rëndësishme të Meshës, të Pagëzimit, të Lutjeve Kishtarë.

Kisha e Currajt të Epërm, për të cilën kanë shkruar albanologë, ambasadorë, akademikë, personalitete fetare nga Vizitor Apostolik e deri famulltarë, historianë, gazetarë, e të tjerë, në tre shekujt kalendarik të fundit është kthye në një vend e institucion fetar, historik, kulturor, arsimor, turistik ndër kohëra, në këtë festë të përbashkët me të ftuar miq e dashamirë nga Shqipëria, Kosova e Diaspora.

Në këtë rast të përrurimit të Kishës të Currajve të Epërm shprehim mirënjohjen tonë të thellë edhe për Ipeshkvin e Sapës, Imzot Dom Simon Kullin, për mbështetjen e tij të vazhdueshme, për prezencën e tij në këtë ngjarje historik, kishtar, kulturor, lokal e rajonal.

Currajt e Epërm kanë luftuar në të gjitha kohërat për liri e pavarësi, për zhvillim, integritim e bashkim kombëtar, duke luftuar në Qafë të Kolçit e në Qafë të Agrit, në Moraçë e në Shtimje, në Plavë-Guci e në Gjakovë, duke pas luftëtarët e vet trima, dëshmorët e vet; duke nxjerrë personalitete të shquara të artit e kulturës, të sportit, të penës, të mjekësisë, e të tjerë, duke ndërtuar jetën e vet në këto troje të të parëve tanë.

Në fillimet e Tranzicionit Shqiptar, në këto tre dekada, fshati ynë i Currajve të Epërm është braktisur si rrallëkund, duke e lënë të vetmuar e të harruar këtë fshat më të bukurit në Ballkan e Evropë, sepse iu mungonte infrastruktura rrugore, sociale, shkollore e të tjera. Për rikthimin e jetës në vendlindjen tonë, në Curraj të Epërm, për popullimin e trojeve e kullave të saj, pas bashkëpunimit dhe kontributit të mirënjohur të popullit të Currajve të Epërm e në mënyrë të veçantë të diasporës dhe të miqve e dashamirësve tanë të shumtë, arritëm suksesin tonë të parë, hapjen e rrugës së makinës në vitin 2018. Pas një lobimi edhe fshati ynë i Currajve të Epërm, është përfshirë në listën e prioriteteve të fshatrave turistike, një nga 115 fshatrat turistike të Shqipërisë.

Kjo do të sjellë edhe më shumë vëmendje shtetërore për studime urbanistike dhe për investime në infrastrukture, hoteleri e të tjera.

Në këtë ditë feste mendojmë se ka ardhur koha më e mirë që të vihet në vend nga Shqipëria jonë propozimi i albanologut të shquar Baron Noçça, i cili në fillim të shekullit XX, pasi kishte ardhur dy herë në Curraj të Epërm, iu drejtua Parlamentit të Austro-Hungarisë për të shpall fshatin historik, kulturor e turistik të Currajve të Epërm në "Monument Culture", në mbrojtje ndërkombëtare.

Fuqia e popullit të Currajve të Epërm, të bijve e bijave të saj në Atdhe e në Diasporat Shqiptare në Botë, qëndron tek forca e bashkëpunimit tonë, tek kontributi ynë i përbashkët për Vendlindjen. Ndaj ju bëjmë thirrje të gjithë pasardhësve të Currajve të Epërm, që të mos e harrojnë kurrë vendin e të parëve të tyre, dhe jo vetëm kaq, por të llobojnë dhe të investojnë gjithmonë e gjithkund për më shumë zhvillim ekonomik, kulturor e shoqëror për Vendlindjen tonë.

Lutja jonë është për më shumë dashuri për vendin, për të ruajtur tokat, pyjet dhe ujërat nga dëmtimi dhe ndotja, për të ruajtur arkitekturën tipike të banesave, traditën

e gatimit, traditën e kuvendeve, traditën e mikpritjes e të fqinjësisë së mirë që kemi pasur e që duhet të kemi gjithmonë.

Tek Suka e Kishës "oda natyrore e kuvendeve" dhe brenda në Kishë u krye betimi i madh i paraardhësve tanë, sipas traditës iliro-shqiptare, ku në "pusin e Kishës" u mbytën "Gurët e Besës" nga burrat e atëhershëm të Currajve të Epërm, se toka e tyre dhe e katundit s' do të shitej, falej a tjetërsohej kurrë jashtë katundit.

Ju falënderojmë dhe urojmë që t'ia kaloni mirë në Curraj të Epërm miq të ftuar, të nderuar, e të kthehemi sa më shpesh në këtë vend të bekuar!

Zoti ju nderoftë, që na nderuat me ardhjen Tuaj ju miq të përjetshëm të Currajve të Epërm!

Zoti i bekoftë Currajt e Epërm me kulla e djepe popullimi, me histori e kulturë shqiptare, me miq e turistë të shumtë, me zhvillim të lartë ekonomik-shoqëror, që ky fshat ndër më të bukurit e Evropës të jetë një nga fshatrat më të zhvilluar të botës!

Curraj Epërm,
6 Gusht 2022

MENDIME E VLERËSIME RRETH LIBRIT TË NDUE SANAJT “KUJTIMET E NJË USHTARAKU”



Shaban Gjura,
studues, publicist

Ne jemi larg “veriorëve” dhe kontaktet me shkollanë dhe rrethinat i kemi të vonshme. Në jetën time për mrekulli dhe mirë-fatim tim, kam takuar, jam njohur dhe jam miqësuar me një zotëri, shok, i bëshëm, i pashëm, me trup basketbolli, ushtarakun e karrierës, me origjinë nga Dukagjini, nga fshati Gjurë/aj -Plan e sot qytetar i Shkodrës. Për çudi mbiemri im është “Gjura”. Para pak kohe më ra në dorë dhe e bëra pjesë të bibliotekës sime, Librin “Kujtimet e një ushtaraku” e Ndue Sanaj, botuar në vitin 2020. Pasi e përfunduar sëm lexuari këtë vepër voluminoze me 660 faqe, më lindi ideja që bashkë me vajzën, mësuese e Historisë dhe Filozofisë në qytetin e Shkodrës, të hedhim në letër mendime, gjykime dhe vlerësime, pa pretenduar se do të jemi të çliruar nga ngarkesa emocionale e kënaqësia që na ngjalli vepra, megjithëse nuk kemi punuar asnjë ditë në armën e ushtrisë popullore kombëtare. Prandaj miku ynë të na falë bashkë me dhjetëra e qindra ushtarake, madje mijëra, bashkëkohës të autorit, nëse shkrimi ynë nuk do të jetë në lartësinë e një shkrimi shkencor.

Ndue Sanaj në veprën e ti vjen si një “faktor historik bërës në familje dhe në fis, si qenie shoqërore që e fillon jetën në gjysmën e parë të shekullit XX-të, si një fëmijë që e ndjen mbi shpinë kujdesin prindëror, në aspektin material, edukativ dhe kulturor, pa e pasur aftësinë të mendonte e të kuptonte se një ditë do të ishte krenaria e familjes dhe e fisit, e më gjerë, se një ditë e një kohë do të ishte funksion shoqëror, me refleksion të gjerë në rrethin shoqëror, ku ai do të punonte. Në kujtimet e tij të cilat mbështeten mbi një ditar të përditësuar jashtë funksioneve shtetërore, Ndueja shkruan se “Ai vjen nga një familje, fis dhe një krahinë me tradita të shquara sociale, kulturore dhe luftarake”, ai vete nuk e kishte menduar dhe kuptuar se një ditë e një kohë, Ai, do të studionte në shkollë “artin e luftës”, e aq më pak ai nuk e kuptonte “përse ekzistonte lufta”. Shqiptarët në raport me popujt e tjerë të Ballkanit e kanë filluar vonë, madje shumë vonë, procesin e shkollimit laik në shkollë kombëtare, dhe Ndue Sanaj i është drejtuar ban-

kave të shkollës, kur ato hapen për herë të parë në zonat ku ai banonte. Në vitin 1957-58, Ai, mbaron arsimin kushtor 7-vjeçar, dhe fiton të drejtën për të vazhduar studimet në Shkollën e mesme për Mjekësi, pasi kishte përfunduar arsimin e detyrueshëm me rezultatet shumë të mira. Pas dekadash Ndueja shkruan: “Sekretari i parë, më thirri dhe mu drejtua, se do të shkosh në shkollë për mjekësi, po më një ndryshim. Do të vishesh me uniformë ushtarake. Sa nuk fluturova nga gëzimi”. Më 5 tetor 1958, Ndue Sanaj fillon shkollën e mesme “Skënderbegas”. Ai shkruan dhe kujton me emocion se “Ajo ditë për mua ishte emocionuese, përcaktuese e të ardhmes time”. Në gjysmën e dytë të shekullit XX-të, Ai, krahas rritjes fizike fillon jetën e tij shkollë me uniformën ushtarake, jetë studentore e mbërthyer në rregull, e mbushur me disiplinë, studim, përgatitje fizike e të tjera.

Në këto fillime rrugëtimi, i gjykuar nga sot jo fort i lehtë, Ndueja nuk u ndal. Ai kaloi vështirësi pas vështirësi të moshës studentore, pragjet e së cilës janë të pafundme, rrugëtoi në strukturat ushtarake

shkallë pas shkalle, reformë pas reforme, gradë pas grade, transformim pas transformimi, dhe aktualisht Ndueja prezantohet jo vetëm “Gjeneral” në sfondin ushtarak por dhe “gjeneral” në fushën e krijimtarisë studimore historike.

Në fund të veprës së tij ai shkruan: “Miq, kolegë, familjare, më pëlqen ta mbyll tërë këtë punë të vështirë, të lodhshme, me postulat. “Lapsi nuk duhet të kishte gomë”, pasi Goma e vërtetë në rastin tonë do të jetë opinioni i lexuesit. “Askush nuk është i përkryer. Kjo është arsyeja përse Lapsi ka Gomë!”

Jetoje Ndue Sanaj kënaqësinë e suksesit, që të vjen nga një fushë larg profesionit tënd bazë, e ashtu si shumë e shumë miqtë tuaj, dhe ne “nuk i përkasim Gomës”, vetëm e vetëm, se ju përfutuat atë të merituarën “Lavdinë”.

E tërë puna e bërë, që ne me bindje e quajmë punë të mirëfilltë shkencore, është ngritur mbi tre kolona cilësisht të dallueshme nga njëra tjetra, por që rrëshqasin mbi të njëjtën transhe.

Kolona e parë e mbështetur fort mbi kohën historike, faktet, ngjarje

dhe vendet historike është trajtimi historik, i fenomeneve historiko-natyrore, të cilat zënë vend me rendësi në vepër. Ndue Sanaj duke e ditur se ka miq dhe dashamirës që nuk vijnë nga fusha ushtarake, duke e menduar se lexuesi në tërësi është shumë herë më i gjerë, ka trajtuar institucionet, vendet, tiparet dhe karakterin e popullsisë në planin historik, duke mos e vendosur veten në rolin e studiuesit “fundor”, por trajtesa të tilla i kanë dhënë veprës frymë, gjerësi, karakter shkencor, tërheqës Librin në të lexuar. E kjo histori e trajtuar që në fillim, ka për objekt traditat historike e ushtarake të Kombit Shqiptar. Ai ka trajtuar ëmbël në kohë dhe në hapësirë historinë e institucioneve kombëtare, që do të përgatisin kuadrin e të gjitha specialiteteve të forcave ushtarake, si një element i “prodhimit” të forcës së një shteti. Rrugëtimin në Shqipërinë veriore apo verilindore, në vepër e ka trajtuar cilësisht në rrafshin historik, duke realizuar ekspozë historike të natyrës, etnogenjenezës, traditave dhe të qëndrësës heroike të banorëve të zonave për identitet kombëtar. Në këto trajtesa, Ndueja dëshmon se profili i ushtarakut, është si motër e profilit të historianit të mirëfilltë. Ai shfaqet si metodist korrekt në fushën e studimeve historike, pasi gjithçka që shkruan e mbështet mbi “kohën historike”, “vendet historike”, “ngjarjet dhe faktet historike”. Të tilla janë trajtesat historike mbi historinë e shkollës ushtarake shqiptare, për Krujë, Bushatin, Pukën dhe kulturën e Komanit, Shkodrën, Hasin, Dukagjinin, Kelmendin e të tjera. Në këtë plan Ndue Sanaj, shfaqet si studiues dhe historian i artit ushtarak, duke ndjekur hapa pas hapi, në kohë dhe hapësirë, ndryshimet sasiore dhe cilësore, të shkollave ushtarake kombëtare, të formacioneve ushtarake, të taktikave dhe strategjive të mbrojtës kombëtare e më shumë, Ai, si profesionist ka trajtuar “Misionin historik të Forcave të Armatosura, të Republikës Popullore të Shqipërisë, të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe se fundmi të Republikës së Shqipërisë. Trajtesat historike, Autori i ka parë dhe vlerësuar si funksion e në shërbim të trupave ushtarake, pasi historia luan rol të rëndësishëm, në mbajtjen gjallë dhe të ndezura, frymën e patriotizmit dhe të gatishmërisë për të realizuar paprekshmërinë, dhe tërësinë tokësore territoriale. Në planin historik, Ndue Sanaj nuk tregohet “miqësor dhe paqësor”, por ndoshta pa kërkuar, pasi më duket se vepra nuk ka atë qëllim, apo mision, ka debatuar me dokumente, fakte dhe argumente, rreth vlerësimit të disa figurave që nuk kanë vetëm refleksion zonal, por dhe Kombëtar. Më ka tërhequr vëmendjen trajtesa historike që autori i ka kushtuar “marshimit të një Brigade ushtarake e përbërë nga forca mikes, ushtarake, studentë, civilë, në shkurt të vitit 1965. Ajo Brigadë do të marshonte në “gjurmët e inkursionit ushtarak të forcave të Brigadës së I



◀ Sulmuese, në periudhën e LAN-ÇL-it, shkurt 1944. Në Luftën Antifashiste në atë marshim luftarak të vërtetë Brigada e Parë me komandant Mehmet Shehun kishte marrë urdhër luftarak “të shpëtonte nga Rrethimi gjermano- ballist Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Partizane”. Jo se rreth kësaj ngjarje të lavdishme të Luftës Antifashiste, nuk është shkruar dhe nuk është folur në historinë e luftës. Vetë Komandanti i saj ka shkruar një vepër madhore “Shteg më Shteg me partizanët e Brigadës së I”. Ndue Sanaj, 30 vjet më vonë ka shkëlur në gjurmët e kësaj Brigade dhe gjysmë shekulli më vonë, Ai, sjell në kujtesën e lexuesit shkodran dhe më gjerë historinë e këtij marshimi që sipas Ndues, dhe në kohë paqe ishte tepër i vështirë. Autori në këtë vepër ka “dalë jashtë funksionit të ushtarakut” dhe kjo është e vërtetë, pasi ai sot jeton e gëzon si qytetar i zakonshëm. Por ai si i ndjeshëm dhe faktor historik bërës dhe si burim historik, me të dhëna të sakta burimore, me kohë, orë, datë, ditë e muaj ka analizuar si një filozof ushtarak, duke hedhur dritë në sfondin historik, mbi disa ngjarje me rrezatim kombëtar, të cilat në shumë se gjithçka kanë sjellë pasoja të rënda e për “fatin e keq –shkruan-Ndueja, ato janë zhvilluar në sensin negativ dhe tragjik”. Kush ka pasur fatin e mirë dhe dashurinë për librin dhe një herësh durimin për të lexuar, ai jo vetën ka vlerësua e kuptuar së si janë zhvilluar ato ngjarje të dala jashtë kuadrin Kushtetues, me karakter të thellë politik, por ka kuptuar dhe pa hezitim ka shkruar se cili ishte pozicioni dhe qëndrimi i një oficeri të lartë (Ndue Sanajt), e si shumë të tjerë që bëhen evident në libër, dhe protagoniste në këto këta ngjarje. Në trajtimin me vërtetësi dhe realizëm historik të këtyre ngjarjeve, Ai, është treguar Vetvetja.

Kolona e dytë që përbën pjesën dërmuese të veprës në planin sasior, është trajtimi i jetës individuale dhe kolektive në struktura e njërës prej armëve kryesore të shteti, siç është ushtria kombëtare e shtetit shqiptar. Jetojmë prej tre dekadash një sistem liberal demokratik kombëtar, ku roli dhe efica e ushtrisë kombëtare duket e “zbehur”. Me gjithë këtë kjo “kolonë” e njohur e jetuar dhe e studiuar mirë, e bën veprën sa historike dhe popullore, por aq dhe funksionale.

Dhe kolona e tretë mbete harmonizimi i të dyjave, pasi është faktori njeri dhe shumtorja e tij populli, që përbën themelin e historisë dhe të ushtrisë tonë.

Autori është treguar mjeshtër i vërtetë në trajtimin e marrëdhënieve të kategorive shoqërore që përbëjnë forcën e ushtrisë popullore dhe të popullit ushtar.

Mosha e rritjes dhe realizimi i pjekurisë intelektuale janë larg njëra tjetrës. Askush nga ne deri në adoleshencë nuk mund të përcaktonte se “unë do të jem” se “unë do të bëhem”. Por kur bisedon me Ndue Sanajn, dhe kur ke shfletuar dhe lexuar librin, krijon bindjen se ai ndjehet krenar që ka qenë kuadër ushtarak i ushtrisë së Republikës së Shqipërisë. Ai shpreh se luftërat për identitet kombëtar zhvilloheshin nga “ushtarake” e “kapedanë”, që mësoheshin të drejtonin dhe të luftonin në zjarrin e luftërave popullore. Ai, Ndue

Sanaj i përket plejadës së ushtarakëve të ushtrisë kombëtare i ngarkuar me mision dhe vizion, i përgatitur me strategji dhe taktikë në kohë paqeje. Por ai vete në faqet e librit ka shkruar se “Ne bëheshim ushtarake të zotë duke mësuar dhe studiuar në shkolla ushtarake nga më të ulëtat deri tek akademitë ushtarake”. Ai e quan veten ushtarak gjitharmësh, pasi ishte domosdoshmëri një përgatitje e tillë. Në këtë plan autori i librit sjell dhe vendos në muret e kulturës tonë kombëtare një vepër të çmuar historiko-ushtarake, paçka se këto 30 vjetët e demokracisë liberale, roli, forca, mobilizimi ushtarak, roli i “gjithë popullit ushtar” janë zbehur dhe harresa kombëtare bën të vetën.

Në vitet 1958-1962 Ndue Sanaj përfundon me rezultate shumë të mira Shkollën 4- vjeçare “Skënderbej”. Mënyra se si Ai, e përshkruan jetën e “begasave” mua si mësues më ka bërë të rikujtoj veten, nxënës e student pa uniformë. Ai ka trajtuar me mjeshtëri artin e mësimdhënies, nga mjaft mësues të fushave të ndryshme, raportet e marrëdhënieve mësues -student, përgatitjen ditore të çdo mësuesi e të tjera e të tjera, duke mos u shkëputur nga ndjesitë që i ngjallte mjedisi ushtarak, të cilin vetë Ndueja e përshkruan, si jo fort të “këndshëm” në fillimet e jetës në shkollën e begasave. Por rrjedhojë e punës këmbëngulëse, vullnetit dhe durimit, në përfundim të shkollës, ai, kishte “siguruar rezultate të larta”. Ai shkruan se, lodhësha, mërzhitesha, nga situata jo të mira, por kurrë nuk e harroja porosinë e babait, ato mu bënë udhërrëfyese gjatë gjithë jetës time. “Kurrë nuk u dorëzove!”. Rrjedhojë e vullnetit për studime, durimi i çdo situatë, e bëri autorin të shprehët, duke mos e tepruar aspak se u “bëra dhe jam dikush”. Ai “dikushi” Ndue Sanaj në këtë stad e kishte hapur “portën e madhe” dhe kishte filluar jetën e ushtarakut të karrierës. Kujtimet e tij, si rrallë herë përbëjnë sot “homazh” dhe respekt për tërë mësuesit, shokët dhe oficerët e viteve 1958-1962.

Në vitet 1962-1964, Ndue Sanaj vijoi studimet e thelluara në fushën ushtarake, në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve “Enver Hoxha” ashtu quhej, në degën e këmbësorisë. “Ne-shkruan Ndueja- ishim matura e dytë e begasave, që vijuan studimet në shkollën e lartë ushtarake të oficerëve”. Pas 6 vjetësh jetë në shkollë e edukimit ushtarak, 4 vjet nxënës (begas) dhe 2 vjet student ushtarak, autori i librit rreshtohet dhe bëhet pjesë e plejadës së oficerëve, me gradën N/toger i klasit të parë. Me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, në fund të nëntorit 1964, Ndue Sanaj emërohet komandant kompanie në kompaninë e zbulimit të Brigadës së Këmbësorisë, me qendër në Fushë-Krujë dhe fillon punë më 1 dhjetor 1964. Kur i hapet dera e repartit dhe merr në dorëzim kompaninë, ai kishte akumuluar në botën e tij intelektuale, tërë atë dashuri dhe respekt, për atë armatë instruktorësh që kishin derdhur djersë e mund për ta mësuar dhe edukuar siç dhe shumë të tjerë. Vrenë, pasi kujtesa e ka ndihmuar shumë ai shkruan. “U jam shumë mirënjohës atyre ish eprore të dashur dhe njerëz, të aftë, që me durim të jashtëzakonshëm përgatitën me dhjetëra breza oficerësh, të cilët punuan me përkushtim për përgatitjen e popul-

lit ushtarë në mbrojtjen e atdheut”. Në moshën 21 vjeçare Ndueja i kishte lënë bankat e shkollës dhe nga i mësuar dhe “objekt edukimi, tashmë ishte bërë mësues ushtarak”. Aty për herë të parë, ai, siç shkruan, filloi të konceptoj, dhe të perceptojë “ushtarin”, vartësin që vinte nga shtesa shoqërore të ndryshme dhe ai “nga i urdhëruar ishte bërë urdhërues”. Ndueja shprehët: Eh punë dhe mision i vështirë. Sa qenkan lodhur të tjerët me ne.. Të urdhërues, të kërkosh të të zbatohen urdhëruat, që buronin nga misioni dhe plotësimi i detyrave”. Në hapat e para të punës si oficer, Ndueja fillon të perceptoi nivelet dhe hierarkinë ushtarake, të konceptoi idetë për përgatitjen e masës së madhe të reparteve ushtarake. Në libër ai përshkruan me mjeshtëri format e punës ideo-politike dhe ushtarake që realizoheshin për të përgatitur, masën e madhe që vinte në radhët e ushtrisë, nga shtesa shoqërore dhe me nivele të ndryshme edukative, me qëllim që të arrije me atë shkallë të lartë ndërgjegjësimi dhe përgatitje të lartë fizike, konformë standardeve që kërkonin rregulloret. Në këtë masë njerëzore, kishte jo pak të paarsimuar, prandaj shprehët autori tërë dijet e marra në banka, kishte ardhur koha që të përgatiteshin mirë në çdo aspekt, që ato t’i përcillnim të faktori “ushtar” si subjekte të punës tonë. Me emërimin, po në detyrën e komandantit të kompanisë, në batalionin e këmbësorisë në Yrshek të Tiranës, Ndue Sanaj jo vetëm e koncepton si forcë, por ai në faqet e librit trajton me kujdes se “çfarë janë forcat rezerviste-vullnetare, strukturën e tyre, puna që bëhej me ta, pasi ata vinin nga profesione dhe pozicione të ndryshme”. Marrëdhëniet ushtar-ushtar rezervist, përbën një linjë më vete, të cilës autori i ka kushtuar vëmendjen e duhur, duke e trajtuar mjeshtërisht në libër. Krahas përshkrimit të tipareve, të karaktereve të ngritjes profesionale ushtarake të ushtarakëve efektivë ai nuk heziton të përshkruajë “ngrohtë” dhe me ndjenjë, tiparet, ndjesitë, përgatitjen ideo-profesionale dhe të ushtarit rezervist. Që në hapat e karrierës ushtarake, Autori i librit ka përshkruar qartë dhe me seriozitet pozicionin dhe funksionin e të “vëzhguarit apo të të kontrolluarit”, pasi siç në çdo strukturë shtetërore, dhe në strukturat ushtarake kontrollat nga “lart” ishin nevojë, kërkesë dhe domosdoshmëri. Objekti i këtyre kontrolleve ishte puna e bërë në terren, dhe rezultatet konkrete të përgatitjes së gjithanshme të reparteve të të gjitha kategorive. Në këtë aspekt, Ndue Sanaj si faktor dhe si historikshkruar, është treguar i vëmendshëm dhe i guximshëm, pasi raportet kontrolues dhe i kontrolluar, nuk përbënte vetëm unitet për shkak të qëllimit të përbashkët, por dhe raport që objektivisht prodhonte diskutim, debat, kundërshti dhe jo rrallë dhe përplasje. Fenomene të tilla autori i ka trajtuar me vigjilencë, pasi shpesh ka vënë në balancë raportet ushtarake, komisar, organizate partie - Komandë të repartit, ka vënë në balancë nivelin e përgatitjes teknike ushtarake të kontrollorit, dhe nivelin ideo profesional të të kontrolluarit, pasi shpesh repartet në stërvitje nuk arrinin të realizonin objektivat, fenomen që të çonte drejt rrugës së gjetjes së shkaqeve.

Në faqet e librit gjenden të përshkruar me dhjetëra e dhjetëra stërvitje, me tematika nga më të ndryshmet, nga stërvitje të “Komandave të shtabeve”, “kompania në mbrojtje”, “batalioni në mbrojtje”, “kompania në sulm”, “batalioni në sulm” e të tjera e të tjera, pa u marrë me punën e planëzuar për realizimin e punimeve mbrojtëse. Ndue Sanaj shprehët se “sa punë duhej për të organizuar një mësim tregues, sa seriozitet, punë përgatitore taktike profesionale dhe ideopolitike, pasi shpesh vëzhguesit vinin nga Ministria përkatëse dhe Shtabi i Përgjithshëm. Eh sa gjatë dhe sa kohë kushtonin analizat që shpesh dhe penalizonin personelin oficer, me masa nga më të ndryshmet. Në muajin mars të vitit 1966, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes Beqir Balluku, Ndue Sanaj vjen në Korpusin e Shkodrës, në Brigadën e 9- të Lehtë dhe pak më vonë në Brigadën e 9 Sulmuese, me qendër në Shkodër, me detyrë komandant kompanie në Bushat. Ashtu si në pozicionet e mëparshëm dhe në Bushat, Ai, prezanton profilin e tij si nga paraqitja e marrja e detyrës. Por autori në librin e tij nuk është marrë vetëm me përshkrimin me korrektësi të praktikave ushtarake, ndjekjen dhe zbatimin e detyrave në reparte, planëzim të stërvitjeve, përgatitjen metodike ditore dhe me gjerë, por me mjeshtëri dhe korrektësi, ka trajtuar marrëdhëniet e tij me eprorët, me homologët dhe vartësit, ka përshkruar me sqimë tipat, karakteret, nivelet e përgatitje ushtarake, ndjenjën e përgjegjëse të dhjetëra e qindra efektivëve, si moshën, profilin, pozicionin, origjinën, jetën e tyre në repartin e jashtë repartit, përshkrime këto që nuk të mërzhisin, por i shtojnë seriozitetin veprës. Në korrik të vitit 1966 Brigada e 9-të Sulmuese transferohet në Pukë, në qendër të qytetit. Jo vetëm historinë dhe kulturën e Komandit, por Ndue Sanaj, dy vitet e qëndrimit në Pukë, i ka përshkruar, me saktësi shkencore dhe bukur, të gjalla dhe frymëzuese, ato që i përkisnin aspektit ushtarak ai ka ditur t’i përshkruaj si ushtarake, ato problematika që i përkisnin shoqërisë civile, ai i përshkruan me ndjenjë të thellë njerëzore dhe artistikisht, siç hallet, shqetësimet e jetës së përditshme, dhe marrëdhëniet popullushtri ai i shihte si kyçin e suksesit. Në një rast ku spikat ndjenja e thellë njerëzore e reparteve ushtarake, në libër autori shkruan. “do të mobilizonin një kompani të forcave sulmues-rezerviste dhe më vjen komisar i kompanisë Zef Cubi dhe më drejtohet: si do të bëjmë me Nikën, të cilit i kishte ndërruar jetë vajza 12 vjeçare, në orët e para të mëngjesit të asaj dite dhe ai ishte paraqitur në repart. Mos u mërzhit i them. Rreshtohet kompania, paraqitet forca dhe i drejtohem Nikës për të dalë nga rreshti. I shtrëngoj dorën dhe e ngushëlloj për humbjen e vajzës. I drejtohem komisarit: Na pri për në shtëpinë e Nikës dhe me tërë efektivin ngushëlluan familjen”

Edukimi dhe studimet ushtarake të autorit nuk kishin përfunduar. Në gusht të vitit 1968, pas pushimeve Ndue Sanaj do të vijojë studimet e larta ushtarake kualifikuese 2 vjeçare pranë “Akademisë së Shtabit të Përgjithshëm “Mehmet Shehu” në Tiranë. Autori shkruan se Akademia e forcave të armatosura si institucion edukativ i llojit të veçantë, ka histori të gjatë, nga viti 1958 deri më 11.

MADHËSHTOR N'ATO BREGORE, PRET BACA KURTI MBI SHTATORE

Po bëhet gati një shekull e gjysmë nga koha kur Baca Kurti mbylli me nder e vulosi me lavdi historinë e tij, për të cilin janë thurur shumë vargje, janë kënduar shumë këngë me lavde e janë shkruar me dhjetëra shkrime e libra për ta mbajtur të gjallë kujtimin e tij, ndër të cilat zënë vend edhe shkrimet e mia.

Ky vigan shtatlartë me virtyte të theku-na malësori, si shqiponja që nuk i trembet as furtunës, as tufanit, këto ditë ka zënë vend i mishëruar në bronz të murrmët, me imazhin e burrit n' 'petka t' malësorit në një bust monumental të vendosur në Grudë të Malësisë. Në vendlindjen e përjetshme të trimit legjendar Baca Kurti.

Ishte mirënjohja më e denjë ndaj këtij "Burri të Madh" që malësorët vullnetmirë e dëshmuar me kontributin e tyre të për-bashkët në nderim të tij, duke investuar për punimin dhe vendosjen e kësaj shtatore hijerëndë, si vetë fjala e peshuam në besnikëri ndaj Malësisë nga Baca Kurti.

Dhe si shumë personaliteteve të shquara të historisë së popullit tonë edhe Baca Kurtit iu ngrit përmendorja e kujtesës, e cila me datë 23 gusht 2022 shënoi vendosjen dhe përjetësimin e tij me lavdi në Malësi.

Atje në Grudën legjendare, ku shekujt lanë veç numra e Kullat qendrestare flijuan djemtë më të mirë, u rikthye Baca Kurti në hekur e në gurë për të mos u larguar më kurrë. Vështrimi i tij i largët në horizont, me një dorë të kapur për palë të xhamadanit e me një qëndrim stoik, duket sikur thërret e lëshon za për ne të gjallët:

-O ju bijtë e kësaj toke!

Amanetin ku e keni?

Trojet që me gjak e mbrojtëm.

Pse po i l'shoni, pse po i lini?



Të vetëdijshëm për vlerat e këtij burri të veshur me imunitetin e mirënjohjes së përjetshme, i përulemi me respekt para

shtatores e njëkohësisht me shumë krenari guxojmë t'i tregojmë botës se Baca Kurti e Bashkohësit e tij luftëtar, ishin e mbeten trima të rrallë.

Gruda e Malësisë ka lindur burra e ka nxjerrë personalitete të shquara sikurse Baca Kurt Gjeka (Gjokaj), i cili sërish çoi peshë e ndezi flakë zemrat e patriotizmit me prezencën e tij.

Baca i Kurt Gjeksës, siç e thërrisnin asokohe grudjanët, lindi rreth vitit 1807 në fshatin Mileshtë të Grudës në një familje me za, ku u rrit dhe u brumos me virtyte të larta patriotike.

Në pjekurinë e tij u shqua për urtësi, besnikëri e trimëri, duke lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë e popullit tonë. Baca



05. 2012, kur me vendime ajo përbëhet nga dy fakultete: "Akademia e Mbrojtjes" dhe "Qendra e Gjuhëve të Huaja". Vitet e studimeve në Akademi të Ndues, përkoinjë me kohën kur Shqipëria zyrtarisht largohet nga Traktati i Varshavës, më 12 shtator 1968. Autori në faqet e librit krahas të tjerash, debaton me pikëpamje të ndryshme që shfaqen sot se "E. Hoxha doli nga traktati i Varshavës për të mbajtur karrigen e vet" e tjera e të tjera. Ndue Sanaj u kundërvë këtyre pikëpamjeve, mendimet e një gazetari Italian, botuar më 11 gusht 2012, nga Bedri Islami. "Shqipëria nuk kishte qenë kurrë kaq e bashkuar as prej gjuhe, as prej feje e as prej race. Ajo u bashkuar nën udhëheqjen e E. Hoxhës, bashkim që nuk e kishte realizuar në kohën e tij as Skënderbeu".

Pas përfundimit të Akademisë më shtator të vitit 1970, Ndue Sanaj paraqitet në Brigadën e 9-të Sulmuese, në Shkodër, e cila përbëhej nga tre batalione, më qendër të Shtabit të Brigadës në Shkodër. Me vendim të Komitetit të Partisë së Korpusit emërohet komandant i batalionit të 1 sulmues, me qendër në fshatin Vukël. Fakti

që autori i Kujtimeve nuk u dorëzua, që në hapin e parë, ai mësoi të ecë, madje dhe të vraponte. Me tërë veprimtarinë e tij disavjeçare me repartet ushtarake, ai na ka sjellë si në "pëllëmbë të dorës" natyrën e Shqipërisë veriore, punën e pafundme në fushën e mbrojtjes, punën e pa kufizuar me njerëzit, duke sfiduar çdo vështirësi.

"Në jetë mund të humbim gjithçka, njeriun e zemrës, paratë, idealet, por më e rëndësishme është të mos humbasim Vetën. Ajo është fatale". Ngjarjet tronditëse të vitit 1997 në shkallë kombëtare ishin me pasoja dhe theks negativ. Në kujtimet e tij që në mënyrë racionale burojnë dhe nga "ditarët" shënime historike të mbajtura në kohën e ngjarjeve, duke mos mbetur vetëm soditës, Ndue Sanaj nuk është marrë shumë me shkaqet dhe zbulimin e tyre, por ka përjetuar pasojat. Ai duke qenë "vetja" dhe "besnik i vetvetes si shumë kolegë të vetit, ka punuar dhe luftuar për minimizimin e pasojave duke sfumuar ato "forca shqiptare" të ngarkuara me gjithfarë idesh, të sillnin sa më pak pasoja shkatërrimtare. Në këndvështrim

spikat karakteri i fortë dhe i kolegëve, të cilët në ato ngjarje "shkatërrimtare madje dhe luftënxitëse" nacionale, të shpalsin para eprorëve misionin e forcave ushtarake. "Ne jemi ushtarakë dhe ushtarë, që historikisht kemi pasur dhe kemi detyrë të luftojmë dhe të mbrojmë atdheun dhe paprekshmërinë e kufijve të shtetit tonë". Ne, nuk jemi forca për të luftuar vetveten. Ne faqet e librit kuptohet qartë se "urdhurat e eporeve kanë mbetur në sirtar". Në libër shkruhet "Shkatërrimi i ushtrisë në pranverë të vitit 1997, jo vetëm kaq, por shkatërrimi i gjithë shtetit, nuk mund të analizohet dhe të nxjerrim përgjegjësitë me mendësi të kohës së monizmit, por duhen pare fenomenet konkretisht në kohën e duhur se si u operua. Unë -shkruan autori -kam bërë përpjekje të të prek diçka"

Hygoi shkruan "Jeta është një lloj paranteze enigmatik midis lindjes dhe agonisë, në mes të syrit që çilet dhe syrit që mbyllet" E drejtë, por për kalimtarët e rëndomtë. Kur lexon veprën e ushtarakut Ndue Sanaj "Kujtimet e një ushtaraku", krijon bindjen se Hygoi nuk ka fort të drejtë. E unë kam krijuar bindjen, dhe men-

Kurti përmendet për guxim të rrallë në mbrojtje të trojeve të Grudës, Malësisë e të trojeve etnike.

Ai nuk u pajtua kurrë me vendimet dashakeqëse të Fuqive të Mëdha për copëtimin e trojeve tona. Si shumë patriot ngriti krye kundër vendimit të Kongresit të Berlinit për t'i dorëzuar Malit të Zi krahinat shqiptare të Hotit, Grudës, Plavës, Gucisë, Kastratit e më gjerë. Në kryengritjen e Malësisë së Madhe radhitet ndër krerët e kësaj Lëvizje.

Baca Kurti u caktua delegat i padis-kutuëshëm dhe vendimmarrës në Lidhjen e Prizrenit. Baca Kurti ishte ndër të parët që rroku pushkën kundër zbatimit të vendimit për zaptimin e trojeve nga Knjaz Nikolla dhe ushtria malazeze, të dhuruara nga Kongresi i Berlinit.

Si shumë burra të denje të Malësisë edhe Baca Kurti nuk u shit me pare. Ai nuk e pranoi shitjen e tokave shqiptare në pazarin e diplomacisë fqinje me atë evropiane. Bashkë me malësorët e dhe patriotët shqiptar, me luftën që bënë kundër Malit të Zi në mbarim të shekullit XIX, vulosën një faqe të artë të historisë së pambarim të Kombit tonë.

Kujtimi i tij janë veprat dhe fjalët që u drejtoi bashkëluftëtarëve vendas për mbrojtjen e Urës së Rzhanicës nga ushtria malazeze: "Vëllazën, anmiku po na mësyen! Kush donë me dekë sot për vend të vet dhe për nder të armëve të veta, të vinë pas meje"! Ishin fjalët e tij ato që ndezën flakë shpirtin e zhuritun të bijve të Grudës e luftëtarëve malësor për tu mobilizuar në këtë luftë të fituar jo prej armëve, por prej zemrës së tyre, duke e detyruar ushtrinë malazeze të tërhiqej me humbje të papritur për nga raporti dhe në numër e në armatim.

Këta ishin burrat malësor që e copëtonin gurin me dhamë për ta ba barot e me të kanë mbrojtje trojet e veta, duke u ba shembull në botë, si Baca Kurti me shokë.

*Shkruar nga
Prof. Gjon Frani Ivezaj*

doj i bindur. "Eh mor Ndue, gjatë madje shumë gjatë, plot një gjysmë shekulli, hap pas hapi, ngjarje pas ngjarje, punë pas pune, debat pas debati, pozicion pas pozicioni ushtarak, gradë pas grade, duke menduar së fundi juaj nuk është ..., por pas 2 mije vjetësh kur vepra juaj të mos ekzistojë më në biblioteka".

Në fund të shkrimit tim, pasi në libër kam kaluar dhe lexuar mijëra e mijëra fakte, tematika qoftë dhe familjare, vlerësime për mijëra emra personalitetesh, që nga ministra e deri tek njeriu më i thjeshtë, po e mbyll me një vlerësim, që autori e ka marrë nga libri i Uinston Çerçill mbi Lutën e Dytë Botërore, që theksonte: "Ushtria nuk është një ndërmarrje me përgjegjësi të kufizuar, që mund të rindërtohet, eliminohet e ndërtohet brenda javësh. Ajo është një qenie e gjallë e në rast se keqtrajtohet ajo trembet, preket, në rast se atakohet vazhdimisht atë e zënë ethet, e në rast se zvogëlohet tej kufijve të lejuar ajo fillon të thahet deri në zhdukje".

Librazhd, gusht 2022

PAS ÇDO ARRITJEJE VJEN NISJA, PAS ÇDO REZULTATI NJË SFIDË E RE!

Me këtë përcaktim e fillova të shkruaj disa mendime për librin, me titull “Tranzicion në udhëkryq”, të autorit N/kolonel Mhill Pali.

Kush është Mhill Dede Pali?

Mhill Pali, u lind në fshatin Gjuraj, të krahinës së Pultit, me 16 janar 1944. Shkollohet në Tiranë në nivelin e shkollës së mesme të përgjithshme. Dëshira për të milituar në radhët e efektivave të mbrojtjes së atdheut e nxiti të ndjekë studimet në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve dhe më pas në Akademinë ushtarake të Shtabit të Përgjithshëm në Tiranë. Ndërkohë ka kryer kurse specializimi në kualifikim pasuniversitar dhe përfundon edhe fakultetin Histori-Gjeografi në Universitetin e Shkodrës ...

Punoi si ushtarak shembullor në Kukës, Vau-Dejë, Lezhe e Shkodër. Me gradën major ai mbylli ciklin e shërbimit në radhët e ushtrisë, pas një qëndrimi 10-vjeçar në postin e komandantit të batalionit të Mbrojtjes Civile të rrethit Shkodër.

Zhvilloi mjaft tema shkencore në fushën e armës së kimisë ushtarake. Shkroi në shtypin e kohës, në gazetën “Pionieri”, “Zëri i Rinisë”, “Shkenca e jeta”, “Bashkimi”, “Luftëtari”, “10 Korriku”, “Gazeta Shqiptare”, “Dukagjini”, “Rilindja demokratike”, “Fakt” e “Shqipnia Etnike”.

Në tryezën e punës së N/kolonelit tashmë në pension presin radhën e botimit libër monografikë, memuaristike dhe letërsi dokumentare. Një vend të rëndësishëm zë fondi i mbledhur e i renditur për mjaft figura të shquara të Dukagjinit e më gjerë, që pret të botohet e të vihet në shërbim të lexuesit.

Ky libër, që po merr në dorë lexuesi, mu dhurua nga autori, me shumë dëshirë, dhe po sa hodha një vështrim kalimtar, nxora përfundimin, se është produkt i një pune të gjatë, sistematike dhe këmbëngulëse, që autori i ka kushtuar shumë vite ..., i cili është shquar për punën sistematike në gjithë jetën e tij.

E lexova me shumë vëmendje, sepse jo pak pjesë e librit ishte edhe në fushën time, të jetës ushtarake dhe përveç asaj, se secili prej nesh ka qene pjesë e atyre ngjarjeve madhore e kombëtare, dhe madje vijojnë edhe sot të jenë pjesë e tyre pavarësisht nivelit dhe profesionit, sepse kanë të bëjnë me jetën tonë të përditshme, me jetën e kombit tonë.

Autori, për këtë libër ka punuar gjatë, në mënyrë sistematike, ditë për ditë, duke mbajtur një ditar mjaft të rregullt, që duhet marre shembull, që nga vitin 1989-1990 e deri në ditën Çlirim të Kosovës.

Mendoj se librin do ta ndajmë në tre pjesë:

Së pari, a duhet të ndryshohet sistemi një partiak në Shqipëri?

Këtë pjesë, N/kolonel Mhilli e ka përshkruar apo më mirë e ka argumentuar me shkrimin, me titull “Disa nga shkaqet, që çuan në dështimin e sistemit socialist-

komunist edhe në Shqipëri”.

Argumenton, se sistemi një partiak në vendin tonë duhet të ndryshohet.

Kjo pjesë e librit, ndahet në katër kolona se, pse ky sistem dështoi:

Kolona e parë, ishte lufta e tmerrshme e klasave, e cila e ndau shoqërinë në dy kampe, me mua ose kundër meje. Ajo pale, që ishte kundër meje, do të shkonte deri në litar. Pra u dhunua njeriu, ndjenja e tij, liria e tij dhe deri sa e damkosi me emrin “me biografi të keqe” dhe e ndau nga pjesa e tjetër e shoqërisë, me një mendësi tepër orientaliste, çka do të thotë: UNI, PËRJASHTIMI dhe AI...

Kolona e dytë, ishte lufta e tmerrshme fetare, deri sa e ktheu vendin, me kushtetute “Vend Ateist”, një qëndrim tejet i veçantë në gjithë botën.

Kolona e tretë, ishte centralizimi i tejskajshëm i ekonomisë. Duhej në orën 02.00 të natës të ngrihej për të zënë radhën për një shishe qumësht, krejt e panevojshme. Pastaj kulmi u arrit me tufëzimin e bagëtive dhe ngushtimin e oborreve personale.

Kolona e katërt, ishte izolimi i tejskajshëm nga e gjithë bota, çka nuk ndodhi me vendet e tjera të lindjes

Së dyti, zhvillimi i proceseve demokratike. Kjo pjesë e librit të N/kolonel Mhillit përshkruan po të thuash gjithë procesin e zhvillimeve të kalimit në sistemin demokratik në Shqipëri, jo vetëm në strukturën ushtarake të shtetit, por në të gjitha qelizat e tij.


Lëvizja për ndryshim filloi në muajin tetor 1989, që u hap muri i Berlinit dhe dy Gjermanit, Gjermania Federale dhe Gjermania Lindore u shkrinë në një shtet të vetëm. Ishte merite e Sekretarit të Parë të KQPKBS, Mihail Graboçovit, Kancelarit të Gjermanisë Perëndimore (Federale), Helmut Kohl dhe Presidentit të SHBA, Ronald Reagan, të cilët me politiken e tyre kundër sistemit socialist, bënë të mundur që ai të dështojë, veçanërisht në fushën ekonomike dhe të lirisë së të drejtave të njeriut.

Shkruhet ideja e Ramiz Alize për të kaluar në sistemin demokratik, që fillon nga thirrja për tu bërë anëtar i PPSH, liberalizimi i pjesëmarrjes në mbledhjet e organizatave bazë të Partisë dhe deri për-pjekjet për të kaluar pagjak në ndërrimin e sistemeve. Vijojnë të për-pjekjet e para të popullit për të goditur shtetin, duke filluar me goditjen ndaj monumenteve, që përcaktonin idealin ekzistencës së shtetit.

Në muajin janar, me datën 14 pëlçet në Shkodër një demonstratë paqësore dhe

rrëzojnë bustin Stalinit, që ishte i vendosur në krye të Lulishtes “1 Maj”, në sheshin kryesor të qytetit, që sot është i vendosur monumenti i të madhit Luigj Gurakuqit.

Me 26 mars 1990, zhvillohet një demonstratë masive antikomuniste në Kavajë. Forca të shumta policore e shtypën këtë demonstratë.



Me 2 korrik 1990, fillon hyrja masive në ambasada të shteteve të huaja, të vendosura në Tiranë. Me mijëra të rinj hyjnë në ambasada në kërkim të azilit politik. Më shumë persona janë futur në ambasadën gjermane dhe atë italiane.

Mbas ngjarjes së 2 korrikut, në Shkodër u hap batuta: “Kafja e vogël në Shkodër, kafja e madhe në Kavaje dhe dasma në Tiranë!”

Pra, në Shqipëri filloi diçka ndryshe, filloi të vritet frika!

Me datën 10 gushte, në Tiranë, me nismën dhe nen drejtimin e Ramiz Alise, mbledhet inteligjenca Shqiptare, kryesisht ajo që ishte në Tiranë, me temë kryesore: “Duhet pluralizmi i mendimit apo pluralizmi politik ..!”

Me 14 nëntor 1990, në varret e “Rrma-jve apo katolike”, me një pjesëmarrje të jashtëzakonshme u çua e para meshë pas 23 vjetëve të ndalimit të fesë me ligj. Pas kësaj, më duket disa ditë më vonë, në xhaminë e “Plumbit”, u bashkuan qindra dhe mijëra njerëz, meshkuj dhe femra, djem e vajza, katolik dhe mysliman, si tek varret e “Rrmajve” dhe zhvilluan faljen

sipas besimit mysliman.

Në Tiranë, me 12 dhjetor 1990 u krijua Partia Demokratike, e para parti opozitare në Shqipëri.

Me datën 13 dhjetor 1990 pëlçet protesta në qytetin e Shkodrës!

Pra, ditari i N/kolonel Mhillit vijon e vijon të mbahet e të pasqyrohet në këtë libër pa u ndalur dhe duke bërë gjitha për-

pjekjet sipas tij, për të kaluar në sistemin demokratik. Madje, në këtë pjesë na paraqiten dhe vështirësitë qoftë në nivel të shtetit, por dhe brenda partive të krijuar, që mjaft mirë na paraqiten zgjedhjet dhe pasojat e tyre në muajin qershor 1996.

Mhilli bën për-pjekje të paraqes, nëpërmjet ditarit të tij, zhvillimin e ngjarjeve pa precedent të pranverës 1997, që të gjitha strukturat e shtetit ranë, përfshi dhe ushtrinë. Ngjarjet e Pranverës së vitit 1997, zanafillën e kanë në zgjedhjet që u zhvilluan në muajin qershor 1996 dhe krijimi i piramidave financiare, të cilat N/kolonel Mhilli bën për-pjekje ta argumentoi mesë miri. Por unë mendoj, se zgjedhjet e muajit qershor 1996 dhe krijimi i piramidave financiare nxiten më tej shkatërrimin e shtetit. Shteti u shkatërrua me moton: “Një Shqipëri e shkatërruar, një dorë e fortë e Serbit në Kosovë!”

Dhe redaktori i librit, z. Zija Vukaj, në parathënie e tij për këtë moment shkruan:

“Brezat, të cilëve u ra fati të përjetonin kthesën historike të viteve ’90, përjetuan një kthesë edhe brenda jetës së vet, brenda shpirtit dhe mendësive, brenda shpresave, pritshmërinë, ëndrrave dhe zhgënjimeve. Zhvillimet dhe ngjarjet e atyre viteve lanë vraga të thella tek shumë individë që kanë aftësinë të ndjejnë e të mendojnë. Së pari njerëzit panë vetveten dhe gjithë shoqërinë së cilës i përkisnin, me tjetër këndvështrim, të çuditur nga iluzionet me të cilat e kishin parë realitetin deri atëherë. Tani gjendeshin ballë për ballë me pamjen e vërtetë të gjërave. Prandaj të gjithë prisnin një jetë më të mirë për veten dhe familjen, duke ndjekur me ankth e shpresë çdo zhvillim që sillte ecja e kohës”.

Pjesa e tretë, mjaft me përgjegjësi na paraqiten zhvillimet në Kosovë, përgjegjësinë e shtetit Shqiptar dhe përgjegjësinë e BE-së e të SHBA. Për-pjekjet e Forcave të Armatosura të NATO-s, që bënë në fushën diplomatike dhe ushtarake për çlirimin e Kosovës.

Ajo na paraqitet, me mjaft përgjegjësi, po të thuash ditë për ditë zhvillimin e ngjarjeve brenda në Kosovë dhe jashtë saj

Pse kaq shumë dhunë!?



Lekë Imeraj

shkrimtar, përkthyes e publicist

Njëra ndër cilësitë më karakteristike të tipave antisocialë ose të desocializuar, është dhuna. Duket sikur e gjithë jeta dhe veprimtaria e tyre udhëhiqet vetëm nga dhuna. Edhe nëse nuk ka konflikte, ata i krijojnë, sepse e kanë të domosdoshme ushtrimin e dhunës. “Mekanizmin e dhunës” e kanë jashtë kontrollit.

Çfarë duhet menduar me dhunë?

Për dhunën, deri më sot, as psikologët dhe as filozofët, nuk kanë mundur të ndërtojnë një përkufizim. Kjo, sigurisht për faktin se, dhuna është shumëfytyrëshe dhe e kudondodhur.

Dhuna përbëhet nga disa elementë, të cilët mendohet se janë: agresioni, dhuna fizike, dhuna psikike, dhuna nga të rinjtë, dhuna strukturore, anarshizmi dhe vandalizmi. Lufta është shkalla më e lartë e dhunës.

Hulumtuesit e trurit dhe botës së brendshme të njeriut, shumë gjëra na i kanë sqaruar. Kështu edhe në lidhje me burimet e dhunës.

Sigurisht, akoma jo të gjitha.

Sipas Frojdit, dhuna është një instinkt i lindur tek njeriu. Ky instinkt i agresionit dhe vrasjes, e qeveris njeriun, si domosdoshmëri e çlirimit të tensioneve dhe energjive të tij të brendshme. Energjia mund të pësojë forma të ndryshme, por asnjëherë nuk shuhet. Ky instinkt, kur ngacmohet nga jashtë, kthehet në agresion, në forcë destruktive.

I këtij mendimi është edhe K. Lorenc... Si njerëzit edhe kafshët, kërkojnë ngacmues të jashtëm, për të çliruar energjitë e tyre të brendshme. Nëse nuk ndodh kjo, atëherë ata rrezikohen nga një “eksplozion” i brendshëm. Ky shkak mendohet të ketë qenë një ndër faktorët e seleksionimit natyral të botës shtazore. Lufta për ekzistencë ka qenë shkaku që, bota shtazore u pajis me këtë instinkt agresiv.

Interesant është fakti që, përse vetëm disa njerëz janë agresivë dhe jo të gjithë!? Përse disa vuajnë nga “sëmundja e humanizmit”, kur të tjerë nuk e njohin fare atë!?

Teoria se agresioni është një instinkt i lindur, u zhvillua dhe vazhdon të zhvil-

lohet në mënyrë të diferencuar. Sipas kësaj, sjellja agresive shkatërron “digat” e instinktit dhe zbut tensionet e brendshme. Tensionet e brendshme duhet të shkarkohen. Në jetën sociale, jo tek të gjithë dhe, kudo mund të kryhet ky proces shkarkimi tensionesh. Tek tipa të veçantë, kjo mund të bëhet në sport, në demonstrata dhe raste anarshizmash.

Krahas teorisë së instinktit, si burim dhune mendohet dhe teoria e pengimit. Këtë teori e mbështeti psikologu amerikan, John Dollard (1900-1981).

Me teorinë e pengimit mendohet, të penguarit e njeriut, për të arritur një qëllim të caktuar. Një të drejt, për të cilën ai është i bindur se i takon. Në raste të tilla, njeriu bëhet agresiv dhe gjithë energjitë e tij të brendshme i përqendron ndaj faktorit bllokues. Bie në konflikt të papajtueshëm me të. Këto energji, fare thjesht mund të shpërthejnë në dhunë. Nëse dikush është duke ecur me makinë dhe, dikush tjetër, në kundërshtim me rregullat ia pret rrugën, brenda sekondës, ai mund të shpërthejë në revoltë. E humbë kontrollin mbi vetveten. Jo në pak raste, nëpërmjet mediave, mësojmë se konfliktet, në të tilla raste, përfundojnë me përgjakje, bile dhe me viktima.

Mohimi i të drejtës, nga drejtësia e degjeneruar apo e vonuar, shkakton tek individit ndjenjën e poshtërimin. Është ndjenja që, e nxitë njeriun, drejtë vetëgjyqësisë.

Shumë psikologë janë të mendimit se, njëri ndër burimet më kryesore të dhunës, është mungesa e respektit të njeriut për njeriun. Ky faktor sjell një kulturë shumë të ulët socialjuridike çka do të thotë: “Gjithkush për vete, edhe mbi tjetrin dhe, sa më shpejt”.

Më ka ndodhur disa herë që, kur kam shkuar diku në zyra, për të kryer veprime, kam pyetur: “Kush është i fundit?” Askush nuk më është përgjigjur. Dhe përse!? Sepse të gjithë duan të futen pa radhë. Secili mundohet t’ia heqë tjetrit edhe atë të drejtë të momentit për t’u futur sipas radhës, pa menduar se çfarë reaksioni mund të shkaktojë një veprim i tillë tek i dëmtuari.

Para ca kohësh, lexova një libër me titull “Pranvera arabe”, nga një autor (antropolog) francez, Emmanuel Todd. Ndër të tjera, aty flitej edhe për Gjermaninë. Titulli ishte: “Gjermania, dje naziste,

sot egoiste”. Në fakt, ato që ai fliste për Gjermaninë e sotme, unë nuk i mora aspak në konsideratë. Mendimet e tij për Gjermaninë, janë puna e tij. Por diçka më bëri përshtypje. Kur fliste për shturjen e jetës sociale në Gjermani, si argument kishte marrë shturjen e lëvizjes në rrugë. “Në Gjermani, trenat, gjithnjë e më shumë vijnë me vonesë dhe këmbësorët, gjithnjë e më shumë, kalojnë në semafor në të kuqe”, citon ai.

Sipas tij, shturja sociale fillon me shturjen e lëvizjes. Nuk e mohoj dot. Nëse do t’u hedhim një sy konflikteve sociale tek ne, pjesa më e madhe e tyre vijnë si pasojë e lëvizjeve të gabuara të njerëzve. Shumë të huaj, të cilët drejtojnë automjete prej vitesh në vendet e tyre, tek ne nuk guxojnë ta bëjnë një gjë të tillë. Kanë frikë, sepse nuk ka rregull. Kështu është kudo tek ne. Jemi një popull që po e sosim jetën duke vrapuar, nga asku për asku dhe, nuk po mësojmë të ecim. Mbetëm në radhë dhe nuk po mësojmë të sillemi në radhë. Nuk po shpëtojmë dot nga konfliktet e lëvizjes. Kur do të mësojmë që me dashamirësi dhe respekt, t’i themi tjetrit: Urdhëroni, ju jeni para meje! Kur do të mësojmë që të mos ia presim rrugën tjetrit dhe, nëse gabimisht ndodh, t’i kërkojmë falje me përlësi! Kur do të mësojmë që, kur futemi në lokal apo diku tjetër, të mos ia lëshojmë derën turinjve atij që vjen pas nesh?



sikur një kronist specialist, duke qenë plotësisht në brendësi të ngjarjeve, madje deri protagonist direkt në ngjarje, që nga vendimi i strukturave të NATO-s, që mori për fillimin e bombardimeve të objekteve ushtarake serbe në Kosovë, që filluan me 24 mars 1999, zhvillimin e atyre veprimeve, përpjekjet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-s) dhe deri për sigurimin e refugjatëve, që në Shqipëri nuk quheshin refugjate, se

vinin te vëllai i tyre dhe deri në çlirimin e Kosovës, i cili u çlirua me 12 qershor 1999, kur Forcat Tokësore të NATO-s u futen në Kosovë nga drejtimi i Maqedonisë së Veriut.

Në mbyllje të këtyre mendimeve, them: Në shumë raste N/kolonel Mhilli jep reflektimet dhe gjykimet e veta mbi ngjarjet e kohës që me të drejtë e ka quajtur “Tranzicion në udhëkryq”. Natyrisht gjykimet dhe reflektimet e tij janë në akord të

plotë me gjithë çfarë mendojnë shqiptarët në përgjithësi, idealist e patriotë.

Mendojë se, ky libër është një prurje e mirë dhe e rëndësishme. Madje, sa më shumë të ecë koha, sa më shumë të kalojnë vitet, sa më shumë që njerëzit t’i largohen historisë së viteve të tranzicionit, aq më i rëndësishëm e i kërkuar do të bëhet ky libër.

Ky libër duhet të jetë në bibliotekën e secilit, se i bën nder asaj.

Sipas Banduras (1973), sjellja e keqe është rrjedhojë e të mësuarit të gabuar. Agresioni është shpërblim i të mësuarit të zgjidhjes së konflikteve në mënyrë luf-tarake. Kjo vjen nga prindërit, shkolla, mjedisi dhe media. Eksperti kriminolog gjerman, Hans-Ludwig Kroeber thotë se, 70 deri në 80 përqind e autorëve të kriminologjisë janë rritur në familje të dhunshme, të desocializuara.

Një mësuese e ciklit të ultë, më tregoi se, një nxënës 7 vjeç, shpesh vinte i gjakosur. Djali nuk tregonte se çfarë i ndodhte. Në shumë raste, djalin e merrnin nga shkolla dy vëllezërit e vet, 12 dhe 15 vjeç. Keqardhja për dëmtimet e fëmijës, e shtyu mësuesen në kërkim të shkakut. Një ditë u vihet pas të tre vëllezërve. Ata, diku, u takuan me një grup tjetër fëmijësh. Dy të rriturit e urdhëruan vëllain e tyre të vogël që të përleshej me fëmijët e tjerë, të panjohur. Luftimi ishte i ashpër. Kur mësuesja i ndau, e pyeti njërin nga vëllezërit, përse ata e bënë këtë masakër mbi vëllain e tyre? Njëri nga ata iu përgjigj: “Duhet të bëhet agresiv, mësuese. Ndryshe nuk ka shanse për të mbijetuar.”

Pasqyra e sjelljes së fëmijëve, në mënyrë agresive apo paqësore, janë të rriturit. Ata gjithmonë imitojnë të rriturit. Influencë të madhe kanë, veçanërisht personat simpatikë ose ata që kanë autoritet social.

Nëse sjellja e dhunshme do të përsëritet shpesh nga një person dhe, ai do të ketë përfitime nga kjo sjellje, ajo mund t’i bëhet atij normë dhe vijë sjelljeje. Ai do të njohë vetëm dhunën, për çdo rast, si mjet për zgjidhjen e konflikteve.

N/kolonel Mhilli të uroj jetë të gjatë, shëndet dhe mos u vononi të na jepni sa më parë për lexim projektet që keni për botim!

Respekt për punën bashkëfshatari e kolegu im N/kolonel Mhill Pali!

Ndue Sanaj,
Shkodër, me shtator 2022

Si i përshkruan shqiptaret një gazetë amerikane, në vitin 1904



Përktheu Armand Plaka

Ky artikull i gazetës amerikane “The Seattle Star”, i datës 29 prill 1904, botuar nga gazeta “DITA” është përkthyer nga studiuesi Armand Plaka dhe ka titullin domethënës: “Shqiptarët, një racë e rrallë; miq dhe armiq të turqve!” (origji: Albanians, strange race; friend and foe of the turks).

Artikulli flet me nota vërtetë pozitive e objektive për shqiptarët, duke i vlerësuar atyre më së shumti virtytet, për të cilat ata në fakt do të dëshironin gjithnjë t’u njiheshin dhe u kundërvihet artikuleve se ata qenkëshin “të egër”.

Por sigurisht se artikulli në fjalë na rrëfen më shumë se kaq. Ai, me termat e sotëm, do të përbente një reklamë të mirë për një komb që sapo kishte nisur luftën për të rigjetur vetveten, në një rrugë që do zgjaste shumë e që vazhdon të hasë në shumë pengesa e sakrificat – shkruan Plaka në DITA.

16 prill 1904, Manastir – Nga vendasit quhet Shqipëri ndërsa nga turqit njihet me emrin Arnautluk. Për këta të fundit, shpesh ajo ka qenë një halë në sy, ose një kërbac në duart e tyre. Shqipëria shtrihet në pjesën jug-perëndimore të Turqisë europiane në koordinatat 39 dhe 43 gradë në veri dhe laget në perëndim nga detërat Adriatik dhe Jon.

Ka një gjatësi prej 290 miljesh dhe gjerësi që shkon nga 40-90 milje. Terreni është malor me 9 varg-male me shtrije veri-jug. Maja më e lartë kap nivelin 8000 këmbë. Një tipar interesant që vihet re në këtë vend janë lumenjtë nëntokësorë si dhe liqenjtë e mrekullueshëm. Eksportet konsistojnë në pambuk, kuaj, dru dhe misër. Shqiptarët janë pasardhës të ilirëve antikë dhe epirotasve. Gjuha e tyre përban disa dialekte me diferenca të theksuara. Popullsia vlerësohet se kap shifrat e 1 milion e gjysëm.

Shqipëria që shtrihet në brigjet e Adriatikut është vendi më i ashpër dhe më i paeksploruar i Europës, ashtu siç është edhe Tibeti në Azi. Ajo çka pjesa e mbetur e kontinentit nuk di rreth këtij vendi, do të përbente material për botimin e një libri të madh. Ajo çfarë di, zor se do të mbushte dot një fletushkë. “Fuqitë e Mëdha” në të shkuarën i kanë kërkuar sulltanit ta rregullojë problemin shqiptar. Sulltani duket se nuk e pëlqente këtë ide, e vetmja mënyrë që ai ta rregullonte këtë punë,

ishtë nëpërmjet religjionit

Është tmerrsisht joshëse për një evropian të shkelë në këto vise. Është po ashtu po aq e rrezikshmë për një shqiptar për ta lënë shtëpinë e tij, qoftë edhe për një distancë të vogël pa u shoqëruar nga një eskortë e madhe, pasi gjakmarrja korsikane s’ka qënë kurrë më krenare sesa ajo e shqiptarëve. Dikush mund të mendojë se shqiptarët janë të egër, por në anën tjetër, ata janë kaukazanë të gjakut më të pastër dhe renditen si populli më fisnik brenda Perandorisë osmane.

Crispi, kryeministri i famshëm Italian, ishte një shqiptar dhe postet në ushtrinë turke dhe administratën civile që kërkojnë zotësi të madhe, kanë qenë vazhdimisht monopol i shqiptarëve. Një oficer ushtrie me origjinë shqiptare, mund të dallohet fare lehtë, pasi ai nuk e ka kokën e ulur dhe vështrimin tinzar të një turku, por mbart një vështrim të hapur me sy të shëndritshëm dhe qëndrimin e një atleti.

Karakteristia të rralla e shënjojnë këtë racë. Ata janë këmbëngulës në qëllime, por me të cilët, brenda rrethanave normale, mund të merresh vesh. Fillimisht ata ishin të gjithë kristianë, por kur u pushtuan nga turqit, u asimiluan në besimin e turqve, duke u bërë kështu i vetmi popull, i cili e ndryshoi besimin në masë.

Ndjenjat e shqiptarit për turkun janë të dyzuara. Ashtu sikurse të gjitha racat e zonave të Maqedonisë, ai (shqiptari) e dëshiron pavarësinë e vet dhe e do këtë para se të vdesë Abdyl Hamiti. Ai do të luftojë për sulltanin duke u vënë në krah të tij e penguar atë për t’i dhënë pavarësinë racave të tjera.

Duke trajtuar religjionin si një levë, zytarëve të sulltanit u duket më e lehtë të merren vesh me shqiptarët, sesa me bullgarët, ndërkohë që këta të parët mbrojnë fuqinë e “të sëmurit të Europës”, klerikët e tyre të lartë u thonë atyre se: rebelimi nuk është dëshira e Muhametit.

Shqiptarët kanë një gjuhë. Alfabeti i tyre konsiston në 30 gërma, një miksturë e rrallë greko-latine. Pushteti turk, gjithsesi, ua ndalon atyre mësimdhënien në shkollë në gjuhën e vet. Italianët dhe francezët kanë kryer një propagandë kristiane në veri dhe në jug, por kanë arritur të konvertojnë vetëm një dhjetë mijë vetë në të gjithë vendin.

Malësorë shqiptarë në fillimvitet 1900

Vetë në Turqi, diçka e tillë do të thoshte vdekje me torturë, pra që një musliman të bëhej kristian, por shqiptarët kristianë dhe muhamedanë jetojnë sëbashku pranë njëri-tjetrit. Shqiptarët janë pra, miq dhe armiq të turkut. Ata kanë luftuar kundër tij si tigra dhe po në të njëjtën mënyrë, edhe përkrah tij. Në këtë moment, ata duken se duan ta bëjnë sërish këtë gjë. Ata janë ofruar për të luftuar kundër fuqive të mëdha për sulltanin dhe para pak kohësh, e mundën atë kur ai dërgoi një ushtri për t’i shtypur.

Ta konsiderosh turk një shqiptar, është një ofezë e madhe për të dhe nuk ka gjë që

do ta bënte atë të luftonte më shumë sesa ta quajë atë turk.

Një gjë për të cilën shqiptari është krenar, është se fjala e tij është po aq e barasvlefshme sa një marrëveshje e nënshkruar. Kjo gjë për turqit nuk merret në konsideratë.

Disa evropianë dikur kaluan në Shqipëri nën mbrojtjen e një bajraktari, miqësinë e të cilit tashmë e gëzonin, dhe që u kishte dhënë fjalën e tij për qëndrim të sigurtë të tyre. Një fis që ishte në gjak me të, vrau një pjesëtar të grupit dhe qysh prej asaj kohe, këto dy fise janë në gjak me njëri-tjetrin.

Sulltani është i lodhur nga dëmshpërbimet dhe nuk do ta nxjerrë zbuluar ushtrinë e tij për momentin në vështirësi, në Shqipëri. Sulltani dhe nëpunësit e trupit diplomatik përdorin shqiptarët si truproja. Kur një shqiptari i besohet një detyrë e tillë, apo jep fjalën, ai e mbron me jetën e vet punëdhënësin e tij.

Mikpritja e shqiptarëve është një virtut i paarritshëm i tyre. Nëse një vrasës që arratiset nga shokët e viktimës së tij, shkel pragun e një shtëpie, edhe nëse kjo shtëpi është e vëllait të viktimës së tij, ai mund të qëndrojë për tri ditë absolutisht i

sigurtë, por pas mbarimit të afatit triditor, ai duhet të largohet. Ai ka në dispozicion 24 orë për t’u larguar dhe që nga ky moment, dyert e gjakmarrjes konsiderohen të hapura.

Shqiptarët i kushtojnë vëmendje veshjes. Kostumet e tyre ndryshojnë sipas zonave, por zakonisht konsistojnë në një këmishë të bardhë, të punuar me dorë, me material prej tekstili të lehtë, me xhakëtë pa mëngë, e punuar bukur me shirita kuq e zi: një brez zakonisht i kuq i lidhur rreth e qark belit, me pjesën fundore që shtrihet plot elegancë poshtë.

Rreth brezit ngjeshen thika dhe pisqolla. Pantallonat janë të lehta të ngjitura pas këmbëve, duke mbuluar këmbët deri mbi këpucë, të punuara nga vithet deri tek gjunjët. Kjo veshje finalizohet me një qeleshe të këndshme dhe ju në fund keni rastin të shihni një krijesë të veçantë.

Nga gazeta amerikane “The Seattle Star”, datë 29 prill 1904, fq. 4. Botuar për herë të parë në shqip nga DITA. Foto kryesore: Taborr turk në fillimvitet 1900, në një ceremoni festive në qytetin e Lezhës.



*** POEZI nga Nikolin Sh. Lëmezhi *** POEZI nga Nikolin Sh. Lëmezhi ***

RRITJE

"Ai duhet të rritet e unë të zvogëlohem"
(Gjn. 3, 30)

Bimët kanë rrënjët,
kanë një terren të mirë,
duhet t'i prashisim e t'i ujisim
që ato të rriten.
Edhe në ecjen shpirtërore
ka rritje
kur vjen një kuptim
dhe dëshirë për t'u rritur.
Pastrohen gjërat e këqija,
si barishtet në ara,
dhe jemi vazhdimisht në rritje.
Bimët nuk e dinë,
nuk kanë vetëdije se po rriten.
E megjithatë ato zhvillohen:
Ka një proces rritjeje për to.
Ashtu është për shpirtin:
Ai rritet.
Jam kujdesur për shumë gjëra
në jetën time:
Tani do të kujdesem edhe për rritjen.
Çfarë kënaqësie
t'u pres koka këtyre gjarpërinjve shpirtërore:
Gëzim që shkon duke u rritur!

VENDIM PËR RRRITJE

*"...mori vendim të palëkundshëm
të shkojë në Jerusalem"* (Lk. 9, 51)

Imagjinoni
çfarë rritjeje mund të ketë
për ne që jemi të vetëdijshëm,
nëse marrim vendim të rritemi,
kur ka rritje edhe për bimët
e për kafshët
që janë të pavetëdijshme!

Maja e Velës
Ti ishe pjesë e ditëve tona,
e palëvizshme në çdo stinë.
Unë gjithmonë këtu të gjej,
o Vela e Kallmetit, ti më kujton fëmijërinë!

Të shoh edhe tani madhështore dhe të bukur,
o maja më e lartë e kësaj toke të bekuar.
Ti e heshtur në shekuj na bën gjithmonë të lumtur
e zemrat drejt qiellit me ty janë lartësuar.

Në gjirin tënd diku aty është fshehur,
Kisha e madhe e shenjtes Eufemi.
Me ujin e bekuar që buron pareshtur,
ajo çdo shtegtari seç i jep freski.

Nga fshatra, qytete e nga brigjet e detit,
me gëzim brohorasin bijtë e Shqipërisë:
Bekuar qofsh ti Vela e Kallmetit,
Lavdi ndër shekuj, o Kisha e shën 'Mrsë.

Mësuesi i brendshëm
Mësuesi im shpirtëror
flet nga brenda.
Zëri i Tij është i qartë
dhe i pagabueshëm:
Unë e dëgjoj.
Do të ndjek mësimet e Tij
gjatë këtij shtegtimi tokësor.

SI MUND TË NDODHË?

*"Unë jam buka e gjallë që zbriti prej qiellit:
nëse ndokush ha këtë bukë, do të jetojë për amshim".*
(Gjoni 6, 51)

Kjo jetë e kufizuar,
përmban brenda
Jetën të Përrjetshme,
në mua.
E si mund të ndodhë
Gjithë kjo?

ME NDIHMËN E HIRIT...

*"... [në duar] do t'i marrin gjarpërinjtë e,
nëse do të pijnë ndonjë send që sjell vdekjen,
nuk do t'u bëjë keq".* (Mk. 16, 18)

Sa koka
gjarpërinjsh shpirtërorë
i preva sot,
me ndihmën e Hirit tënd,
o Zot!

DUHEJ TË NDODHTE KËSHTU!

"...Hyji në gjithçka bashkëpunon me ata që e duan".
(Rom. 8, 28)

Duhej patjetër
të kaloja përmes gjithë këtyre rrugëve,
që të gjeja Rrugën.
Bekuar, pra,
edhe ato hapa të gabuar,
sepse edhe falë tyre erdha këtu,
ku ka Dritë,
pa asnjë gabim!

MËSIM

*"Përnjëmend, përnjëmend pot ë them:
kush nuk lind përsëri prej së larti,
nuk mund ta shohë Mbretërinë e Hyjit".* (Gjn. 3, 3)

Merrni mësim tek fëmijët, o njerëz!
Kur ata mësojnë të flasin,
sa herë gabojnë e gabojnë,
e ne qeshim me gabimet e tyre!
Kur mësojnë të ecin,
sa herë e sa herë rrëzohen,
e ne e dimë se ngrihen përsëri,
më të fortë se përpara.
Duke gabuar mësojnë të flasin,
duke gabuar mësojnë të ecin.
Edhe ne kështu:
Duke u rrëzuar, mësojmë...
E ç'mësim nga jeta,
për Jetën!

LUMTURI

Ka asish që e kanë gjetur personin e duhur,
por nuk e kanë kuptuar se është ai;
ka prapë asish që e kanë gjetur rrugën e duhur
dhe çuditërisht nuk e dine se është ajo.
Ka prapë të tjerë që nuk e kanë gjetur
as personin as rrugën e duhur
dhe të gjithë janë të trishtuar e të pakënaqur.
E në fund, ka prej atyre që kanë gjetur
Personin dhe rrugën e jetës
e janë të vetëdijshëm për këtë,
prandaj dhe janë të lumtur.



*** POEZI nga Frederik Ndoci *** POEZI nga Frederik Ndoci ***



Vëllimi i III me poezi
- pjesa e pare -

(Vijon nga nr. 220)

LAMTUMIRË NANË!

Anderr Frojdiane
Rreth shtratit të saj
Tan jan mbledh aty
qysh se ofsham e saj
me za i afroi.
Asht tuj hjek shpirt mama.

Jan tan nj'aty afër saj,
Tan fëmijët për rreth saj nj'aty shtang për rreth,
ajo don me buzqesh
E lëshon një "ah"
Mbyll sytë e leht thot "jam mir!"

Por n 'shpirt mallkon ket hillnim
që fëmijëve tash po i shtin.
Që s'mundet si gjithmone
me i prit me krah hap.

Tan nipa e mbesa jan aty,
rreth saj që edhe pak po shkon,
ne sytë e saj te that
ka mbet një lot shkretine
Për lojnat e prallat e saj
me nipat e mbesat,
Si gjithmon

Ah e shkreta mamma!
Kot nja si kot e puthin
qe t'i ringrohet gjaku
nder faqe,
që po i largohet,
me shikime e ambla të saj
dhe sy të lagun e të palumtun,
Mundohet ti kryqëzoh me sytë tan
që rrezohen shpejt përdhe
Si një kamera vështrimi i saj
jo tuj kerku ndihme,
Por don me na ndihmu
mos me u ligshtu.
Hmhmhmhmuf
Asht tuj na lan Mamma!
Shejtja Mri,
Nana e Tenzot,
bekue kjoft gjini yt.

..ah statuj e saj po ngrin,
nder tan shpirtat tan!

E duert tona drejtue drejt qiellit këndojnë
Ave Maria, Ave Maria!

Kush mund ta peshoj dashunin mallëngjyese
Oh sa shumë dashni,
Ka rreth teje oh mamma
e sa shumë dhimbje,
Ka n 'zemrat tona
Qe po na i shtryll pa m'shire
Kjo sken aq e papajtueshme

Dashni e pafund
që s'matet me asgja,
Në këto çaste kaq të vështira
për shpirtat tan të ngurr,
oh moj mamm!

E gjer atje jasht,
nder shkall e korridor,
jan qindra njerëz,
Po durojn diellin që djeg.
Se asht tuj na lan Mamma!

Aroma e rakis së mirë,
që n'putir i u ofrohet,
Eh ska asnji që e merr
as sa me e provu,
Vullnetin e Hyjit n'ket dit
Hezitojn leht me u pajtu!
Sa ma pagan n 'këto çaste
E si Promethe thjesht me rrebelu.

edhe pse putiri me raki,
n 'kësi çastesh
asht për lamtumir
për at që po shkon,
për çfarë ka hjek
e asht gezue nga kjo jet.

E vështir me e than, por kështu asht!
Kush nuk guxon me kja,
por dikush fshin ndonji lot.

Nji kitarr ndihet nga larg,
dikush po këndon
nina-nana
ah Mamma!

e tan atmosfera e botes
e mbushun në at ninulle
Jeta atje jasht
gjithkund vazhdon!

e tinguj të ambel në at dhome,
të qeshjes së një
fëmije pa faj,
askush nuk e ven vesh,
Askush s'ia kthen buzëqeshjen atij fëmije
se Mamma po shkon.

gratë me pëshpërimita fjalësh,
sepse kështu thone:
i vjen ndoshta gjum,
krejt si një fëmije

kur vjen nata,

Në kor lehtë këndojn
Ave Maria
Ave Maria
ah mamm
po t 'thërrasin
gjumin e madh!

Fryma e saj fundit kaq ngjyre dhimbje
Shkul shpirtat tan që bërtasim e kja
Që të gjith na
jetime tashma
Përqafohena
e ska kush na pajton
ah ah mamma
shkoi e na la.

O POET JO BEJTAXHI

"Kështu mendimit tem monist, në qëndrimin ndaj mikut
Agron Duka, duke harru se demokracia pranon mendi-
min ndryshe. Ai mendon si atëherë e un i lindur ndryshe
edhe atëherë, por mbetem rebel qysh atëherë, nga që de-
mokracia nuk ka lind akoma në Shqipëri"

Mbaroi lufta e u dishru buka ,
Baballart se kan harru.
Po ti shkruer do bejta A. Duka.
Kur Evropa rrafsh për dhe u rrëzu.

Rrafsh Parisi, Roma e Londra.
Varshava, Praga, Beogradi
N 'Gjermani germallat kodra.
Rrafsh për dhe dhe Stalingradi.

Nja 10 ksolla më qerpiq.
në Tiran krejt u rrafshuen.
Hyn neverenver e popoviç.
Ky bythq.. mbasi i shker... eu gruen.

Filloi e mbyti tan atdhetaret.
Për çdo dit pa u lodh,
Vrau priftërinj e gjith shkollaret.
E për ty hapi ca shkoll.

Me aq shkoll sa more ti,
Lind'te n 'Shkodër çdo fëmij.
Që të mbetej në histori,
T'msoj ti thuesh bejts:-poezi.

N 'Shkodër të gjith e kan të leht.
N 'gaz hare e kur i pijn 5 gota,
T'ban gjith kush n'moment nji bejt,
N 'sa poetet ia njeh gjith bota.

Asht e leht me i thur kang.
Diktatoreve dhespoteve e kultit.
N 'sa Shkodrani se bani gjakun lang.
Kurr si than marshallah m...it.

Shih gjermanin si e zbardh dita.
shkatrru 100 her ma shum ai vend.
Ndertuem hidrocentrale që t 'mos kemi drita.
Votojm njeriun e ri që vjell e t 'tremb.

REDAKSIA

Kryeredaktore: **LUIGJ SHYTI**
Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika,
Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan
Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon
Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi botimin:

LAZËR KULLA
Kanada

